



**AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË
ARSIMIN E LARTË**

Vlerësimi Institucional i Institucioneve të Arsimit të
Lartë në Shqipëri

**Raporti i Akreditimit Periodik Institucional
të Universitetit Epoka**

Korrik 2021

GRUPI I VLERËSIMIT TË JASHTËM:

1. Z. Kevin Kendall Kryetar
2. Prof. Anila Hoda Anëtare

Përmbajtja

Rreth këtij vlerësimi.....	4
Konteksti i këtij vlerësimi	5
Raporti i përmbledhur.....	6
Përmbledhje e gjetjeve.....	8
Praktika e mirë	8
Pikat e dobëta	9
Rekomandimet	9
Konfirmimi i veprimit të ndërmarrë.....	9
Gjykime përmbledhëse për çdo Fushë Vlerësimi	9
Gjykim i përmbledhur	9
Raport i detajuar	10
Fusha e vlerësimit 1: Organizimi dhe Menaxhimi i tij.....	10
Gjetje	14
Praktika e mirë	14
Pikat e dobëta	14
Rekomandimet	14
Konfirmimi i veprimit të ndërmarrë.....	14
Vendimi	14
Fusha e Vlerësimit 2: Burimet	15
Gjetje	19
Praktika e mirë	19
Pikat e dobëta	19
Rekomandimet	19
Konfirmimi i veprimit të ndërmarrë.....	19
Gjykimi	19
Fusha e Vlerësimit 3: Kurrikula	20
Gjetje	24
Praktika e mirë	24
Dobësitë	24
Rekomandimet	24
Konfirmimi i veprimit të ndërmarrë.....	24
Gjykimi	24
Fusha e Vlerësimit 4: Mësimdhënia, Mësimnxënia, Vlerësimi dhe Kërkimi.....	25
Gjetje	27
Praktika e mirë	27
Pikat e dobëta	27
Rekomandimet	28
Konfirmimi i veprimit të ndërmarrë.....	28
Gjykimi	28
Fusha e Vlerësimit 5: Studentët dhe Mbështetja e tyre	29
Gjetje	31
Praktika e mirë	31
Pikat e dobëta	31
Rekomandimet	31
Konfirmimi i veprimit të ndërmarrë.....	31
Gjykimi	31
Lista e Evidencave.....	32

Rreth këtij vlerësimi

Qëllimi kryesor i Vlerësimit Institucional është të vlerësojë se sa institucionet e arsimit të lartë (IAL-të) i përmbushin Standardet Shtetërore të Cilësisë në Shqipëri, që hynë në fuqi në vitin 2011. Vlerësimi Institucional është procesi i vlerësimit nga grupi i ekspertëve të vlerësimit, që përbëhet nga një ndërthurje e ekspertëve ndërkombëtarë dhe shqiptarë të caktuar nga ASCAL.

Raportet përkatëse nuk shërbejnë vetëm për akreditimin institucional, që bazohet në shkallën e përmbushjes së standardeve nga IAL-të, por edhe për t'iu ofruar IAL-ve, qeverisë shqiptare, publikut dhe studentëve informacion për mënyrën se si IAL-të përmbushin standardet. Ky raport i ndihmon gjithashtu IAL-të të identifikojnë prioritetet që kanë nevojë për përmirësim (procesi që ofruesit e arsimit të lartë zbatojnë për përmirësimin sistematik të cilësisë së ofrimit dhe mënyrave për mbështetjen e të nxëniet të studentëve).

Standardet Shtetërore të Cilësisë në Shqipëri janë grupuar në pesë kapituj, Fusha Vlerësimi: Organizimi dhe Menaxhimi i tij; Burimet; Kurrikula; Mësimdhënia, Mësimnxënia, Vlerësimi dhe Kërkimi; dhe Studentët dhe Mbështetja e tyre. Ky raport identifikon karakteristikat e praktikave të mira, rekomandimet, pohimet e veprimeve në zhvillim e sipër dhe dobësitë për çdo Fushë Vlerësimi, duke përfshirë gjykimin se në çfarë niveli IAL-ja i përmbush standardet. Format e gjykimit që ekspertët mund të japin janë: standardet janë përmbushur plotësisht; standardet janë përmbushur kryesisht; standardet janë përmbushur pjesërisht; ose standardet nuk janë përmbushur.

Së fundi, vlerësuesit e përmbyllin procesin duke rekomanduar një gjykim përmbledhës për Bordin e Akreditimit të ASCAL-it. Gjykimi i përmbledhur është një nga katër nivelet e mëposhtme:

- **Standardet Shtetërore të Cilësisë janë përmbushur plotësisht.**
- **Standardet Shtetërore të Cilësisë janë përmbushur kryesisht.**
- **Standardet Shtetërore të Cilësisë janë përmbushur pjesërisht.**
- **Standardet Shtetërore të Cilësisë nuk janë përmbushur.**

Konteksti i këtij vlerësimi

Themeluar në vitin 2007, Universiteti Epoka është një institucion i arsimit të lartë, në veri të kryeqytetit, pranë Aeroportit Ndërkombëtar të Tiranës. Ky institucion është themeluar dhe është nën pronësinë e "Turgut Ozal Education SH.A.". Në vitin 2012, Ministria e Arsimit dhe Sportit lejoi ndryshimin e statusit ligjor të këtij institucioni nga "Shkollë e Lartë" në "Universitet".

Universiteti Epoka ofron 33 programe studimi në tri Fakultete: Fakulteti i Arkitekturës dhe Inxhinierisë, Fakulteti i Ekonomisë dhe Shkencave Administrative, dhe Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Sociale. 33 programet e studimit përfshijnë 11 programe Bachelor, 8 programe të Masterit Shkencor, 6 programe të Masterit profesional, 2 programe të Masterit të Integruar, dhe 6 programe doktorature. Lëndët e ofruara janë: ekonomiks, biznes, financë-bankë, informatikë biznesi, marketing, drejtësi, shkenca politike, inxhinieri civile, inxhinieri kompjuterike, dhe arkitekturë. Të gjitha programet mundësohen në gjuhën angleze. Universiteti ka lidhur partneritet me 66 universitete në shumë vende, si: SHBA, Mbretëri e Bashkuar, Itali, Gjermani, Francë, Rumania, Poloni, dhe Bullgari. Është anëtar i Shoqatës Ndërkombëtare të Universiteteve (IAU) dhe anëtar i asociuar i Shoqatës Evropiane të Universiteteve (EUA). Universiteti gjithashtu është pjesëmarrës në një sërë projektesh ndërkombëtare, duke përfshirë projektin Erasmus dhe projektin Horizon 2020.

Ky Universitet ka katër qendra kërkimore: Qendra për Studime Evropiane, Qendra e Kërkimit dhe Projektimit në Shkenca të Aplikuara, Qendra e Edukimit të Vazhdueshëm, dhe Qendra Yunus për Biznes Social dhe Qëndrueshmëri, të cilat ushtrojnë veprimtarinë e tyre nën varësinë e Rektoratit. Universiteti Epoka aktualisht ka 83 punonjës akademikë me kohë të plotë dhe 2,527 studentë në të gjitha programet. 83 për qind e studentëve janë në ciklin e studimeve Bachelor. Mësimi zhvillohet në një kampus të veçantë, me godina bashkëkohore, ku gjenden auditorë, laboratorë, studio, një bibliotekë, si dhe hapësira sociale dhe argëtimi. Krahas kësaj, kampusi ka edhe një bllok rezidencial ku mund të akomodohen rreth 100 studentë. Në këtë bllok rezidencial përfshihen edhe mensat dhe hapësirat sportive. Të gjitha godinat janë moderne dhe të mirëmbajtura.

Misioni i Universitetit është "të jetë një institucion risiprurës dhe ndikues mësimdhënies dhe kërkimi, që iu shërben vlerave njerëzore themelore nëpërmjet prodhimit, shpërndarjes, dhe zhvillimit të njohurive në nivel ndërkombëtar; si dhe të kontribuojë në përmirësimin e cilësisë së jetës së shoqërisë mbështetur në nevojat kombëtare dhe rajonale. Në këtë kontekst, Universiteti Epoka synon të zhvillojë individë të mirëpërgatitur, produktivë, dhe kompetentë, që orientohen drejt kërkimit, kanë etikë profesionale dhe ndjeshmëri sociale, si dhe janë të hapur ndaj sfidave kombëtare dhe ndërkombëtare."

Raporti i përmbledhur

Raporti i vetëvlerësimit u hartua nga një grup i Universitetit, ku përfshiheshin punonjës të nivelit të lartë, staf akademik dhe mbështetës, si dhe një përfaqësues i studentëve. Gjatë hartimit të raportit të vetëvlerësimit, grupi pati akses në dokumentacion nga departamentet akademike dhe administrative, si dhe e bazoi punën e vet në parimet e objektivitetit, transparencës, paanshmërisë, dhe respektit ndaj autonomisë akademike. Projektraportet iu shpërndanë një audience më të gjerë për koment, përpara përfundimit dhe miratimit nga Senati Akademik.

Dokumenti i Vetëvlerësimit ofron informacione rreth historikut të Universitetit, adreson rekomandimet nga vlerësimi i mëparshëm në vitin 2017, si dhe trajton secilën Fushë Vlerësimi në veçanti. Gjykimi i grupit të vetëvlerësimit për çdo fushë vlerësimi: Organizimi dhe Menaxhimi i tij; Burimet; Kurrikula; Mësimdhënia, Mësimnxënia, Vlerësimi dhe Kërkimi; si dhe Studentët dhe Mbështetja e tyre, është se standardet janë përmbushur plotësisht.

Vizita virtuale u zhvillua më 26 dhe 27 maj 2021. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm përbëhej nga një ekspert i nivelit të lartë për arsimin e lartë, nga Mbretëria e Bashkuar, dhe nga një vlerësues me përvojë nga një universitet shqiptar. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm mbështetej nga Menaxheri i Vlerësimit, i caktuar nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL). Grupit të Vlerësimit të Jashtëm iu vu në dispozicion Raporti i Vetëvlerësimit dhe 266 dokumente mbështetëse, tetë javë përpara fillimit të vizitës së vlerësimit, dhe grupi nuk kërkoi asnjë evidencë tjetër dokumentare. Përmes dokumentacionit të ofruar, grupi arriti të njihej me strukturën, politikën, procedurat e drejtimit, si dhe me natyrën e mësimdhënies dhe veprimtarisë kërkimore të ndërmarrë nga Universiteti. Këto dokumente përfshinin Statutin e Universitetit, rregulloret akademike, raportet vjetore, politikën e pranimi, listën e marrëveshjeve të jashtme dhe memorandumet, listën e projekteve kërkimore, shembujt e informacioneve rreth programit, si dhe dokumentet e mbledhjeve vendimmarrëse.

Gjatë vizitës u zhvilluan një sërë mbledhjesh, që i mundësuan grupit të kuptonte përgjegjësitë, procedurat, dhe pikëpamjet e stafit dhe studentëve. Grupi u takua me Rektorin, drejtuesit e lartë, studentët e ciklit të parë, të dytë, dhe të tretë, stafin akademik, administrativ, dhe mbështetës, si dhe partnerët e jashtëm, alumnit, dhe punëdhënësit. Gjithashtu, grupi realizoi mbledhje specifike me Dekanët dhe Përgjegjësit e Departamenteve, me përfaqësuesit e Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, si dhe me Grupin e Vetëvlerësimit. Gjatë të gjitha mbledhjeve u mbajtën shënime, që shërbyen si burim reference dhe evidence vetëm për Grupin e Vlerësimit të Jashtëm. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm zhvilloi edhe një tur në kampus, gjatë të cilit vizitoi bibliotekën, hapësirat e mësimdhënies, laboratorët, dhe zyrat. Pas vlerësimit të të gjitha evidencave të vëna në dispozicion, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm arriti në përfundimet e renditura në vijim.

Fusha e Vlerësimit 1: Organizimi dhe Menaxhimi i tij: Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi dy karakteristika të praktikës së mirë, dhe nuk evidentoi asnjë dobësi, nuk dha

asnjë rekomandim, si dhe nuk bëri asnjë pohim. Karakteristikat e praktikës së mirë lidheshin me planifikimin e përgjithshëm strategjik dhe procesin e rishikimit, si dhe politikën favorizuese tejet të efektshme për mobilitetin e stafit akademik dhe studentëve në nivelin ndërkombëtar. Krahas kësaj, janë marrë parasysh edhe dy pohimet e mëparshme lidhur me krerët e qendrave kërkimore dhe rishikimin e anëtarësisë së Bordit të Etikës. Për këtë arsye, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm gjykoj se standardet për këtë fushë janë përmbushur plotësisht.

Fusha e vlerësimit 2: Burimet: Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi dy karakteristika të praktikës së mirë në lidhje me zhvillimin e Sistemit Ndërveprues EPOKA (EIS), që mund të përdoret në mësimdhënie dhe mësimnxënie, kërkim, administrim dhe menaxhim, si dhe në zhvillim infrastrukture dhe burimesh të përshtatshme për mësimdhënie dhe mësimnxënie, me qëllim mbështetjen e programeve të studimeve. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë dobësi, nuk dha asnjë rekomandim, si dhe nuk bëri asnjë pohim. Praktika e mirë e mëparshme në lidhje me programin e aktiviteteve sociale në Universitet është ende e pranishme, por është penguar nga pandemia e shkaktuar nga COVID-19. Për këtë arsye, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm gjykoj se standardet për këtë fushë janë përmbushur plotësisht.

Fusha e Vlerësimit 3: Kurrikula: Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi katër karakteristika të praktikës së mirë, dhe nuk evidentoi asnjë dobësi, nuk dha asnjë rekomandim, si dhe nuk bëri asnjë pohim. Praktika e mirë lidhet me ofrimin e diplomave të dyfishta me Universitetin e Shkencave të Aplikuara, në Mainz, Gjermani, mbështetjen individuale që jepej nga këshilluesit e studentëve në nivelin e kurseve duke monitoruar dhe duke mbështetur ecurinë dhe arritjet e studentëve, ofrimin e programeve në gjuhën angleze, çka promovon mobilitetin e studentëve në Shqipëri dhe në mbarë botën, si dhe sistemin e stazheve që organizohen nga Universiteti, duke iu ofruar studentëve një larmi mundësish punësimi, çka mbështet zhvillimin e punësueshmërisë së studentëve. Rekomandimi në akreditimin e mëparshëm, që lidhet me qartësimin e përllogaritjes dhe mundësisht të pakësimit të orëve mësimore, është adresuar, dhe për këtë arsye Grupi i Vlerësimit të Jashtëm gjykoj se standardet për këtë fushë janë përmbushur plotësisht.

Fusha e Vlerësimit 4: Mësimdhënia, Mësimnxënia, Vlerësimi dhe Kërkimi: Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë praktikë të mirë, asnjë dobësi, nuk dha asnjë rekomandim, si dhe nuk bëri asnjë pohim. Universiteti Epoka i përmbush të gjitha kriteret e Fushës së Vlerësimit 4, ofron programin studimor të miratuar, si dhe ka procedurën për përmirësim të vazhdueshëm, duke përfshirë një politikë për rritjen e cilësisë së mësimdhënies. Universiteti Epoka ka prioritet të qarta kërkimore dhe nxit kërkimin, sidomos në nivelin ndërkombëtar. Për këtë arsye, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm gjykoj se standardet për këtë fushë janë përmbushur plotësisht.

Fusha e Vlerësimit 5: Studentët dhe Mbështetja e tyre: Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi dy karakteristika të praktikës së mirë, por nuk evidentoi asnjë dobësi, nuk dha asnjë rekomandim, si dhe nuk bëri asnjë pohim. Karakteristikat e praktikës së mirë lidheshin me ofrimin e gjerë të bursave për studentët e disavantazuar, organizimin e ekipeve të futbollit dhe volejbollit, si dhe me 22 klubet studentore aktive, që organizojnë aktivitete, si: forume, workshop-e, dhe programe trajnimi ku iu japin certifikata

pjesëmarrësve dhe organizatorëve ose ndajnë çmime në konkurse kulturore dhe edukuese. Praktika e mirë e mëparshme, që lidhet me informacionet, këshillat dhe udhëzimet që iu jepeshin studentëve dhe organizatave gjatë Panairit të Punës, vazhdon pavarësisht kufizimeve për shkak të COVID-19. Krahas kësaj, janë marrë parasysh pohimet që lidheshin me përfshirjen e studentëve me aftësi të kufizuara në politikën dhe procedurat e pranimeve, si dhe me përfaqësimin e studentëve në komisionet vendimmarrëse. Për këtë arsye, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm gjykoj se standardet për këtë fushë janë përmbushur plotësisht.

Përmbledhje e gjetjeve

Praktika e mirë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi karakteristikat e mëposhtme të praktikës së mirë:

- planifikimi i përgjithshëm strategjik dhe procesi i rishikimit që marrin parasysh prioritetet kombëtare dhe ndërkombëtare **[Pika 1.9, Kapitulli III, Standardi I.5].**
- Universiteti ndjek një politikë favorizuese tejet të efektshme për mobilitetin e stafit akademik dhe të studentëve në nivel ndërkombëtar **[Pika 1.18, Kapitulli III, Standardi III.4].**
- Sistemi Ndërveprues EPOKA (EIS), i zhvilluar në universitet nga Zyra e Koordinimit të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit, për t'u përdorur në mësimdhënie dhe mësimnxënie, kërkim, administrim dhe menaxhim **[Pika 2.9, Kapitulli III, Standardi VII.2].**
- zhvillimi i infrastrukturës dhe burimeve të përshtatshme për mësimdhënie dhe mësimnxënie, me qëllim mbështetjen e programeve të studimeve **[Pika 2.11, Kapitulli III, Standardi VII.4].**
- diplomat e dyfishta me Universitetin e Shkencave të Aplikuara, në Mainz, Gjermani **[Pika 3.8, Kapitulli I, Standardi I.4].**
- mbështetja individuale që jepej nga këshilluesit e studentëve në nivelin e kurseve duke monitoruar dhe duke mbështetur ecurinë dhe arritjet e studentëve **[Pika 3.12, Kapitulli I, Standardi I.8].**
- ofrimi i programeve në gjuhën angleze, çka promovon mobilitetin e studentëve në Shqipëri dhe në mbarë botën **[pika 3.14, Kapitulli I, Standardi I.10].**
- sistemi i stazheve që organizohen nga Universiteti, duke iu ofruar studentëve një larmi mundësish punësimi, çka mbështet zhvillimin e punësueshmërisë së studentëve **[Pika 3.14, Kapitulli I, Standardi I.12].**
- ofrimi i gjerë të bursave për studentët e disavantazuar **[Pika 5.4, Kapitulli I, Standardi III.4].**
- organizimi i ekipeve të futbollit dhe volejbollit, si dhe 22 klube studentore aktive, që organizojnë aktivitete, si: forume, workshop-e, dhe programe trajnimi ku iu japin certifikata pjesëmarrësve dhe organizatorëve ose ndajnë çmime në konkurse kulturore dhe edukuese **[Pika 5.8, Kapitulli I, Standardi III.8].**

Pikat e dobëta

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë dobësi.

Rekomandimet

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk dha asnjë rekomandim.

Konfirmimi i veprimit të ndërmarë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk bëri asnjë pohim.

Gjykime përmbledhëse për çdo Fushë Vlerësimi

1. Standardet për Organizimin dhe Menaxhimin e tij **janë përmbushur plotësisht.**
2. Standardet për Burimet **janë përmbushur plotësisht.**
3. Standardet për Kurrikulën **janë përmbushur plotësisht.**
4. Standardet për Mësimdhënien, Mësimnxënien, Vlerësimin dhe Kërkimin **janë përmbushur plotësisht.**
5. Standardet për Studentët dhe Mbështetjen e tyre **janë përmbushur plotësisht.**

Gjykim i përmbledhur

Vlerësuesit i rekomandojnë Bordit të Akreditimit se në Universitetin Epoka, Standardet Shtetërore të Cilësisë **janë përmbushur plotësisht.**

Raport i detajuar

Fusha e vlerësimit 1: Organizimi dhe Menaxhimi i tij

- 1.1 Universiteti Epoka hartoi statutin e ri në vitin 2016 **(13)** për të përmbushur kërkesat e ligjit aktual për arsimin e lartë në Shqipëri, i cili u miratua **(14)** nga Ministria e Arsimit dhe Sportit në vitin 2017. Statuti u miratua nga Senati Akademik dhe Bordi i Administrimit **(16)**. Skema organizative e Universitetit **(42)** mundëson ofrimin e shërbimeve në përputhje me statutin, dhe universiteti është i organizuar dhe menaxhohet sipas rregulloreve të brendshme, direktivave, udhëzimeve, kodeve, dhe politikave **(M6, M9, M10, M11, M12, 15)**. Ndaj, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm gjykoi se Universiteti dhe strukturat e tij punojnë në përputhje me statutin. **[Kapitulli III, Standardi I.1].**
- 1.2 Misioni i Universitetit është “të jetë një institucion risiprurës dhe ndikues mësimdhënies dhe kërkimi, që iu shërben vlerave njerëzore themelore nëpërmjet prodhimit, shpërndarjes, dhe zhvillimit të njohurive në nivel ndërkombëtar; si dhe të kontribuojë në përmirësimin e cilësisë së jetës së shoqërisë mbështetur në nevojat kombëtare dhe rajonale”. Statuti **(13)** parashikon që Universiteti “të zhvillojë individë të mirëpërgatitur, produktivë, dhe kompetentë, që orientohen drejt kërkimit, kanë etikë profesionale dhe ndjeshmëri sociale, si dhe janë të hapur ndaj sfidave kombëtare dhe ndërkombëtare”. Rregulloret, direktivat, udhëzimet, kodet, dhe politikat **(15)**, si dhe skema organizative **(42)** e bëjnë të mundur këtë mision. **[Kapitulli III, Standardi I.1].**
- 1.3 Në zbatim të ligjit, Universiteti është organizuar në tri fakultete që prej vitit 2017 dhe ofron programe në tri cikle studimi, përkatësisht Bachelor, Master, dhe Doktoraturë **(M3, M4, M5, 18)**. Fakultetet janë si vijon: Fakulteti i Arkitekturës dhe Inxhinierisë, Fakulteti i Ekonomisë dhe Shkencave Administrative, dhe Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Sociale **(M10, 42)**. Universiteti ka edhe tri qendra kërkimore, përkatësisht Qendra për Studime Evropiane, Qendra e Kërkimit dhe Projektimit në Shkenca të Aplikuara, dhe Qendra Yunus për Biznes Social dhe Qëndrueshmëri (<http://epoka.edu.al/home-about-epoka-about-epoka-1-1039.html>). **[Kapitulli III, Standardi I.1].**
- 1.4 Universiteti organizohet sipas statutit **(13, 42)** dhe ka vendosur hierarki të strukturave vendimmarrëse për çështjet administrative, financiare, akademike dhe studentore. **(M10, M12)**. Organet vendimmarrëse kryesore janë Senati Akademik dhe Bordi i Administrimit, dhe drejtuesit përfshijnë Rektoren, Zëvendësrektorin, Administratorin, dhe Dekanët e tri fakulteteve **(M2, M10, M12)**. Senati Akademik zhvillon 10 mbledhje gjatë vitit akademik dhe është përgjegjës për mësimdhënien, mësimnxënien, kërkimin shkencor, dhe vendimmarrjen sipas rasteve **(19)**. Bordi i Etikës **(42)** garanton përputhshmërinë me Kodin e Etikës së Universitetit (20), dhe përbëhet nga pesë anëtarë, duke përfshirë Zëvendësdekanin e Studentëve dhe Zëvendëspresidentin e Këshillit Studentor, si dhe anëtarët e zgjedhur të stafit akademik nga çdo fakultet **(DVV)**. Rekorati është organi ekzekutiv i Universitetit, që mbledhet të paktën çdo dy javë dhe ka si funksione kryesore hartimin e planit strategjik të zhvillimit **(28)**, propozimin për financim dhe burime pranë Bordit

Administrativ, si dhe monitorimin dhe publikimin e vlerësimit të aktiviteteve të Universitetit **(M12, 24, DVV)**. *[Kapitulli III, Standardi I.2].*

- 1.5 Përpara fillimit të çdo viti akademik, Rektorati iu kërkon të gjitha departamenteve që të paraqesin propozimet buxhetore për burime fizike dhe njerëzore për vitin e ardhshëm **(M10, 21)**. Pas vlerësimit nga Rektorati, këto propozime i përcillen Bordit Administrativ për miratim **(22)**. Rektorati gjithashtu vendos mbi mbështetjen financiare të pjesëmarrjes së anëtarëve të stafit akademik në konferenca dhe evenimente ndërkombëtare, si dhe botimin e shkrimeve të tyre në buletine ndërkombëtare **(M6, M10, 23)**. Bordi Administrativ garanton përmbushjen e misionit dhe qëndrueshmërinë financiare të Universitetit **(M12, 13, 25)**. Bordi përbëhet nga pesë anëtarë, të cilët caktohen nga Bordi Mbikëqyrës i Shoqërisë Themeluese, dhe drejtohet nga Administratori i Universitetit **(DVV, M12)**. *[Kapitulli III, Standardi I.2].*
- 1.6 Rektori mban titullin “Profesor”, caktohet për 4 vjet, drejton Senatin Akademik, dhe siguron zbatimin e vendimeve të këtij të fundit **(M12, DVV)**. Çdo fakultet menaxhohet nga Dekani, i cili është gjithashtu anëtar i Senatit Akademik **(M12, DVV)**. Përgjegjësit e Departamenteve caktohen nga Dekanët e Fakulteteve **(M10)**. Administratori i Universiteti caktohet nga Bordi i Administrimit dhe është autoriteti më i lartë përgjegjës për menaxhimin administrativ dhe financiar të Universitetit, sikundër parashikohet në Statut **(13)**. *[Kapitulli III, Standardi I.2].*
- 1.7 Në përmbushje të kërkesës së Statutit **(13)**, të gjitha autoritetet dhe njësitë administrative dhe akademike të Universitetit i kanë rolet dhe përgjegjësitë e përcaktuara sipas fushës së tyre të autoritetit dhe ekspertizës. Mbledhjet zhvillohen në mënyrë periodike, si dhe axhendat **(20)** dhe dokumentet shoqëruese qarkullohen paraprakisht, dhe vendimet merren sipas strukturës formale të mbledhjeve në përputhje me rregullore **(15)**, çka u konfirmua gjatë mbledhjeve me stafin e Universitetit **(M6, M9, M10, M12)**. *[Kapitulli III, Standardi I.3].*
- 1.8 Organet kolegjiale kryesore të Universitetit janë Senati Akademik, Rektorati, Bordi Administrativ, Bordi i Etikës, dhe Komisioni i Përhershëm i Sigurimit të Cilësisë (KPSC). Këto organe garantojnë përputhshmërinë dhe zbatimin e rregullave dhe rregulloreve të Universitetit, si dhe i mundësojnë Universitetit që të respektojë kufijtë e autonomisë së tij **(DVV, 13, M10, M12)**. Krahas kësaj, Universiteti ka ekspertë dhe përfaqësues të jashtëm që marrin pjesë në proceset vendimmarrëse. Një shembull i këtij rasti janë dy nga anëtarët e Komisionit të Përhershëm të Sigurimit të Cilësisë **(RVV, 148)**. Universiteti është i organizuar në mënyrë të tillë që arrin të përfitojë nga fondet e programeve të BE-së, si: Horizon 2020 dhe Erasmus + **(M6, 155)**. *[Kapitulli III, Standardi I.4].*
- 1.9 Strategjia e parë për Zhvillimin e Universitetit, në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, u hartua në vitin 2012 dhe zbatohet për periudhën 2013 - 2017. Sikundër vërtetohet në raportin përfundimtar gjithëpërfshirës, kjo strategji ka qenë e efektshme **(27)**. Universiteti aspiron që të mbështetë edhe strategjitë aktuale kombëtare për zhvillimin, si dhe të rritë kërkesën për arsim të lartë. “Epoka” synon të luajë një rol më të madh në zhvillimin vendor, kombëtar, dhe rajonal, si dhe të ketë më shumë ndërveprim me komunitetin vendor dhe botëror. Në vitin 2017, Universiteti hartoi Strategjinë Kuadër 2018 - 2022 **(M2, 28)**, një dokument shumë i qartë, i hollësishëm, dhe i gjithanshëm, i cili mbulon sfidat, vizionin, objektivat, menaxhimin, burimet njerëzore dhe fizike, sigurimin e cilësisë, përfshirjen komunitare dhe sociale, si dhe

rretëzimin dhe mobilitetin ndërkombëtar. Kjo strategji është diskutuar imtësisht brenda Universitetit (**M6, M9, M10, M12**) dhe është miratuar nga Rektori, Senati Akademik dhe Bordi i Administrimit. Çdo njësi akademike dhe administrative ka planet e veta strategjike, bazuar në strategjinë e Universitetit, ku paraqesin hollësisht objektivat e tyre dhe mënyrën se si do të mbështetin strategjinë e Universitetit (**M10, 29, 30**). Ka një program për rishikimin e rregullt dhe përditësimin sipas nevojës së ecurisë me zbatimin e planeve strategjike (**M10, DVV**). **Grupi i Vlerësimit të Jashtëm gjykoj se planifikimi i përgjithshëm strategjik dhe procesi i rishikimit, që marrin parasysh prioritetet kombëtare dhe ndërkombëtare, janë pikë e fortë e Universitetit dhe shembull i praktikës së mirë. [Kapitulli III, Standardi I.5].**

- 1.10 Sipas ligjit, Universiteti Epoka i paraqet Ministrisë së Arsimit dhe Sportit një raport vjetor. Raporti përmban aktivitetet kryesore të Universitetit gjatë vitit, duke përfshirë arritjet dhe të dhënat mbështetëse. Krahas kësaj, ofron informacione edhe rreth misionit, arritjes së objektivave, financave, burimeve financiare, vlerësimit, dhe rekomandimeve (**38**). Raporti vjetor miratohet përmes strukturës së komisionit të brendshëm të Universitetit (**M12**) dhe shpërndahet në format të shtypur dhe elektronik në faqen zyrtare të Universitetit (<http://www.epoka.edu.al/home.html>). **[Kapitulli III, Standardi I.6].**
- 1.11 Universiteti ka ngritur struktura të përshtatshme për përmbushjen e misionit dhe qëllimit të tij. Strukturat organizative dhe menaxheriale parashikohen në Statut (**13**) dhe Universiteti e ushtron veprimtarinë e tij në përputhje me to dhe me dispozitat e ligjit përkatës në Shqipëri (**14**). Krahas kësaj, në përputhje me Statutin (**13**), Universiteti garanton autonomi të plotë të Senatit Akademik (**M12**) dhe liri akademike për stafin akademik (**M6**). Stafi akademik ka liri në procesin e mësimdhënies, mësimnxënies, dhe kërkimit, në përmbushje të strategjisë së Universitetit (**M6, 28**). Të gjitha njësitë në Universitet janë autonome sipas fushave të tyre të përgjegjësisë. Këto njësi përfshijnë Qendrën për Studime Evropiane (**31**) dhe Qendrën e Kërkimit dhe Projektimit në Shkenca të Aplikuara (**32**). **[Kapitulli III, Standardi II.1].**
- 1.12 Universiteti Epoka ka tri Fakultete: Fakulteti i Arkitekturës dhe Inxhinierisë, Fakulteti i Ekonomisë dhe Shkencave Administrative, dhe Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Sociale. Qendra për Studime Evropiane është njësi bazë, në varësi të Fakultetit të Drejtësisë dhe Shkencave Sociale, ndërsa Qendra e Kërkimit dhe Projektimit në Shkenca të Aplikuara dhe Qendra Yunus për Biznes Social dhe Qëndrueshmëri janë përgjegjësi e Rektoratit, sikundër ilustron edhe në skemën organizative (**42**) dhe sikundër u konfirmua gjatë mbledhjeve me stafin (**M6, M10, M12**). Këto fakultete ofrojnë programe studimi të ciklit të parë, të dytë, dhe të tretë në studime profesionale, shkenca sociale dhe studime humanitare (**18, 33**). Në përputhje me Statutin dhe Rregulloret, çdo fakultet përbëhet nga tri departamente dhe secili prej ka të paktën shtatë punonjës me kohë të plotë (**M10, 115**). **[Kapitulli III, Standardi II.1].**
- 1.13 Universiteti Epoka ka një faqe zyrtare gjithëpërfshirëse (<http://www.epoka.edu.al/>), ku jepen informacione të hollësishme rreth strukturës së Universitetit, misionit dhe objektivave, sigurimit të cilësisë, kritereve të pranimit, stafit akademik, kërkimeve, orareve, mbështetjes së studentëve, dhe programeve të ofruara. **[Kapitulli III, Standardi II.1].**
- 1.14 Struktura e Universitetit, që përshkruhet më lart dhe paraqitet në organigramë (**42**), mundëson vendimmarrje gjithëpërfshirëse nga personat e duhur në komisione/borde.

Përpara marrjes së çdo vendimi përfundimtar zhvillohen konsultime të plota, në hapësirën e duhur, sipas parashikimeve të Statutit **(M6, M9, 13)**. Ky fakt vërtetohet nga një propozim i Komisionit të Përhershëm të Sigurimit të Cilësisë **(34)**, dhe nga një vendim që është marrë gjatë njëres prej mbledhjeve të Rektoratit **(35)**. Gjithashtu, në përputhje me Statutin **(13)**, anëtarët e stafit në departamente përfshihen në vendimmarrjen e për departamentet e tyre përkatëse, dhe punonjësit akademikë me kohë të plotë nga çdo fakultet janë anëtarë të Asamblesë së Përgjithshme të Stafit Akademik **(M6, M10)**. Vlen të përmendet se Universiteti ka zbatuar një plan të efektshëm strategjik kundër COVID-19 **(184)**, në konsultim dhe me mbështetjen e plotë të stafit **(M6, M10, M12)**. **[Kapitulli III, Standardi II.3]**.

- 1.15 Universiteti Epoka kryen dhe shqyrton studime tregu për të pasuruar procesin e zhvillimit të programeve **(M10)**. Disa programe të rëndësishme që theksohen në Strategjinë Kuadër **(28)**, si arkitektura, inxhinieria civile, teknologjia e informacionit, dhe biznesi, luajnë rol madhor në zhvillimin e ekonomisë shqiptare **(M2, M12)**. Qeveria shqiptare thekson mësimin e lëndëve profesionale, pasi ndihmon në ofrimin e më shumë mundësive të punësimit **(DVV)**. Departamentet kryejnë studime tregu për të justifikuar zhvillimin e programeve të reja, si: Inxhinieria Softuerike **(37)**, dhe këto propozime merren përmes fakultetit për miratim në Senatin Akademik **(M10, M11, M12)**. **[Kapitulli III, Standardi III.1]**.
- 1.16 Zyra e Planifikimit të Karrierës dhe Studentëve të Diplomuar gjurmon punësimin e të diplomuarve, përmes telefonit, email-it, postës, dhe medias sociale **(M9)**. Këto të dhëna publikohen në Raportet Vjetore të Universitetit **(38)** dhe tregojnë, për shembull, se në periudhën 2018-2019, përqindja e punësimit të të diplomuarve ishte 87.4%, 42.9% e të cilëve punonin në sektorin privat, 18.9% punonin në Administratën Shtetërore, dhe 16.4% vijuan studimet në programet Master. Universiteti Epoka zbaton kuadrin ligjor të Republikës së Shqipërisë në lidhje me konkurrencën në tregun arsimor. Ky angazhim është ndërthurur në Statutin e Universitetit **(13)**. **[Kapitulli III, Standardi III.1]**.
- 1.17 Universiteti Epoka është zotuar që të bashkëpunojë dhe të lidhë partneritet, sikundër parashikohet në Planin Kuadër Strategjik **(28)**, si dhe të mbështesë ndërkombëtarizimin, sikundër konfirmohet nga Plani Strategjik për Ndërkombëtarizim 2018 - 2022 **(30)**. Ky plan ka objektiva në lidhje me markën e universitetit, mobilitetin, bashkëpunimin për kërkime, kurrikulën, dhe zhvillimin e kampusit. Universiteti është treguar aktiv në promovimin e shkëmbimeve të stafit dhe studentëve përmes Erasmus +, ndonëse vitin e kaluar pandemia e shkaktuar nga COVID-19 e ngadalësoi mobilitetin. Universiteti ka një listë të gjatë marrëveshjesh ndërkombëtare me Institucionet e Arsimit të Lartë dhe institucionet joarsimore, që përfshijn 95 ofrues të arsimit të lartë, shumica prej të cilëve ndodhen jashtë Shqipërisë **(135)**. Universiteti nxit mobilitetin kombëtar dhe ndërkombëtar të stafit dhe studentëve, dhe i mbështet si nga pikëpamja logjistike, ashtu edhe nga ajo financiare **(M6, M10)**. Krahas kësaj, Universiteti mirëpret staf dhe studentë ndërkombëtarë në Tiranë, dhe ka politikat dhe procedurat e nevojshme në këtë drejtim **(39, 40, 41)**. Duhet vërejtur marrëveshja me Universitetin Mainz, në Gjermani, në kuadër të të cilës ofrohet një program me diplomë të dyfishtë në Biznes Ndërkombëtar. Përmes këtij programi, studentët e “Epokës” kalojnë dy semestra në Mainz dhe dy profesorë marrin pjesë në procesin e shkëmbimit **(M7)**. **[Kapitulli III, Standardi III.2 Standardi III.3]**.

- 1.18 Zyra e Marrëdhënieve Ndërkombëtare në Universitet organizon seanca orientimi për të gjithë studentët e rinj dhe punonjësit që marrin pjesë programe mobiliteti, ndërsa Zyra e Burimeve Njerëzore ndihmon të gjithë punonjësit e huaj me procedurat, që lidhen me marrjen e lejes së punës, lejes së qëndrimit, dhe kartelave shëndetësore. Në këtë mënyrë lehtësohet integrimi i stafit dhe studentëve të rinj në Universitet, sikundër vërtetohet nga programi i orientimit **(172)**. **Grupi i Vlerësimit të Jashtëm gjykoj se Universiteti ka një politikë shumë të efektshme që favorizon mobilitetin e stafit akademik dhe studentëve në nivelin kombëtar, çka e konsideron si praktikë të mirë. [Kapitulli III, Standardi III.4]**

Gjetje

Praktika e mirë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi karakteristikat e mëposhtme të praktikës së mirë:

- planifikimi i përgjithshëm strategjik dhe procesi i rishikimit që marrin parasysh prioritetet kombëtare dhe ndërkombëtare **[Pika 1.9, Kapitulli III, Standardi I.5]**.
- Universiteti ndjek një politikë favorizuese tejet të efektshme për mobilitetin e stafit akademik dhe të studentëve në nivel ndërkombëtar **[Pika 1.18, Kapitulli III, Standardi III.4]**.

Pikat e dobëta

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë dobësi.

Rekomandimet

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk dha asnjë rekomandim.

Konfirmimi i veprimit të ndërmarë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk bëri asnjë pohim.

Vendimi

Standardet për Organizimin dhe Menaxhimin e tij **janë përmbushur plotësisht.**

Fusha e Vlerësimit 2: Burimet

- 2.1 Universiteti Epoka e bën publike organigramën e vet **(42)** në faqen zyrtare, në Statut **(13)**, dhe në Raportet Vjetore të Universitetit **(38)**. Krahas kësaj, Universiteti ka edhe një numër të madh punonjësish me kohë të pjesshme, që janë të punësuar si akademikë ose profesionistë të fushës së tyre dhe iu kërkohet të ofrojnë shërbimet e tyre sipas nevojës **(182)**. Procesi i rekrutimit për stafin me kohë të plotë dhe të pjesshme realizohet në përputhje me Rregulloren për Rekrutimin e Stafit **(43)**. Kriteret për çdo vend vakant publikohen në faqen zyrtare të Universitetit (<http://www.epoka.edu.al/>) krahas përshkrimit të punës **(M6, M10, 42)**. Pozicionet e punës gjithashtu reklamohen në botime kombëtare dhe ndërkombëtare **(45)**. Informacionet rreth kriterëve dhe procedurave për rekrutimin e stafit paraqiten qartësisht në direktivat përkatëse të Universitetit **(46, 47)**, dhe të gjitha kuptohen dhe zbatohen nga stafi **(M6, M10)**. Procedurat e rekrutimit, duke përfshirë kriteret e punësimit dhe vlerësimit, parashikohen në rregulloret e brendshme **(43)** dhe janë në përputhje me Statutin **(13)**. Procedurat e rekrutimit janë transparente, kuptohen nga stafi **(M6, M9)**, dhe kandidatët fitues, qofshin staf akademik **(M6)** apo mbështetës **(M9)**, nënshkruajnë një kontratë punësimi **(48)**. Në përputhje me strategjinë e ndërkombëtarizimit, Universiteti Epoka mirëpret staf të kualifikuar nga universitete ndërkombëtare, dhe në fakt, 60% e stafit akademik në Universitet janë trajnuar në vende të ndryshme të botës (182). Mësimi në Universitetin Epoka jepet në gjuhën angleze dhe të gjithë punonjësit akademikë **(M6)** dhe mbështetës **(M9)**, si dhe studentët **(M3, M4, M5)** që u takuan me grupin flisnin shumë mirë anglisht, çka tërheq aplikime ndërkombëtare për punë në Universitet. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm gjykoi se Universiteti Epoka zbaton një politikë të hapur për punësimin dhe rekrutimin e burimeve njerëzore. **[Kapitulli III, Standardi IV.1].**
- 2.2 Stafi i ri në Universitetin Epoka merr pjesë në seanca orientimi **(172)**, që organizohen nga Zyra e Burimeve Njerëzore dhe Zyra e Koordinimit të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit. Krahas kësaj, atyre iu jepet një Udhëzues Stafi **(49)**, që ofron informacione gjithëpërfshirëse rreth punës në Universitetin Epoka. Stafi i ri ka edhe akses në një mori informacionesh të tjera në faqen zyrtare të “Epokës” (<http://www.epoka.edu.al/>). “Epoka” ofron një mjedis mikpritës për stafin e ri **(Tur)**, të cilët përfshihen në shumë aktivitete të Universitetit, si: organizimi i ditëve informuese për studentët e mundshëm. Një shembull i këtij rasti është Panairi Edukues, ku “Epoka” ka një hapësirë të vetën dhe iu ofron informacione **(50)** nxënësve të shkollave të mesme rreth programeve të studimit dhe mundësive për bursë. Punonjësit e rinj marrin pjesë në aktivitete sociale, duke përfshirë drekat mikpritëse dhe organizimet joformale, në mënyrë që të njihen më mirë me Universitetin, menaxherët dhe kolegët, si dhe të promovohet integrimi më i gjerë. Nga diskutimet me stafin, ishte e qartë që “Epoka” ndjek një politikë që e favorizon integrimin e stafit në jetën sociale **(M6, M9, M10)**. **[Kapitulli III, Standardi IV.2].**
- 2.3 “Epoka” ofron trajnim dhe zhvillim për stafin akademik dhe administrativ në përputhje me Strategjinë Kuadër dhe Planin e Veprimit **(28)**. Çdo departament ka një plan trajnimi që shënjestron nevojat e stafit, si dhe çdo fakultet ka strategjinë e vet të zhvillimit **(52)**. Plani përfshin trajnime për zhvillimin e kërkimeve, projektme kursesh, edukim digjital, ndërkombëtarizim, përgatitje projekte, si dhe Microsoft Teams **(52)**. Universiteti merr pjesë në disa programe të Erasmus + **(53)** dhe stafi është përfshirë

në trajnime, që lidhen me mësimdhënien, mësimnxënien, dhe ndarjen e praktikave të mira **(54)**. Punonjësit nxiten që të marrin pjesë në një sërë aktiviteteve sociale dhe profesionale, si: udhëtime me stafin, forume të hapura, dhe promovime libri **(DVV)**. Stafit mbështetet si nga pikëpamja financiare, ashtu edhe nga ajo logjistike për të marrë pjesë në konferenca, dhe për të çuar më tej kualifikimet e veta akademike përmes Zyrës së Kërkimeve dhe të Projekteve dhe Zyrës së Marrëdhënieve Ndërkombëtare **(M6, 55, 56)**. Ngarkesa e punës së stafit rregullohet në mënyrë të tillë që merr parasysh mësimdhënien dhe kërkimet sipas direktivave të duhura **(M6, 41, 57)**. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm gjykoj se “Epoka” zhvillon vlerësim periodik të aftësive të stafit, dhe ofron trajnime sipas nevojës si për individët, ashtu edhe për Universitetin. **[Kapitulli III, Standardi IV.3].**

- 2.4 Universiteti Epoka ofron një shumëllojshmëri aktiviteteve sociale për stafin dhe studentët, me qëllim promovimin e dialogut social **(M4, M6)**. Në hapësirat universitare ndodhet një mjek **(Tur)** për stafin dhe studentët e “Epokës” në rast se kanë probleme shëndetësore, dhe Universiteti siguron jetën dhe shëndetin e stafit. Krahas kësaj, Universiteti zbaton rregulla të qarta për të përcaktuar përgjegjësitë sipas funksioneve përkatëse të stafit, në përputhje me Rregulloren për Disiplinën e Stafit Menaxherial, Akademik, dhe Administrativ **(62)**. Për këtë arsye, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm gjykoj se Universiteti i menaxhon burimet njerëzore me efektshmëri. **[Kapitulli III, Standardi IV.4, Standardi II.2].**
- 2.5 Përpara fillimit të vitit akademik, Rektori iu kërkon departamenteve, fakulteteve, dhe stafit mbështetës dhe administrativ që të paraqesin nevojat e tyre për burime njerëzore dhe fizike në përputhje me strategjinë dhe planet e departamenteve **(M10, M12)**. Rektori i shqyrton nevojat, merr vendimet përkatëse, dhe harton një plan të hollësishëm për diskutim në Senatën Akademik dhe për miratim nga Bordi i Administrimit **(M10, M12, 63)**. Në të njëjtën kohë, Rektori iu kërkon njësitëve planet e tyre për veprimtaritë dhe aktivitete që pritet të zhvillojnë gjatë vitit të ardhshëm akademik **(64)**. Këto aktivitete përdoren nga Administratori për të hartuar buxhetin e Universitetit për vitin e ardhshëm akademik dhe për t’ia paraqitur Bordit të Administrimit për miratim **(M10, M12)**. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm gjykoj se Universiteti e harton buxhetin në përputhje me procedurat e përcaktuara. **[Kapitulli III, Standardi VI.1].**
- 2.6 Pas miratimit të buxhetit, Zyra e Financës, nën mbikëqyrjen e Administratorit, shpërndan dhe zbaton buxhetin përmes njësitëve individuale **(M10)**. Menaxhimi i burimeve financiare monitorohet në përputhje me ligjet përkatëse në Shqipëri **(65)** dhe Standardet Shqiptare të Kontabilitetit **(66)**. Kopjet e buxhetit dhe zbatimi i tij janë të disponueshme në Zyrën e Administratorit dhe në Zyrën e Financës **(M9, 182)**, dhe përmbledhen në Raportin Vjetor **(38)**. Universiteti Epoka është pjesë e Turgut Ozal Education sh.a. dhe ata kryejnë një audit të jashtëm vjetor, përmes Deloitte, dhe raportet e auditit janë të disponueshme në Zyrën e Financës të Universitetit **(DVV)**. Për këtë arsye, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm gjykoj se Universiteti ofron mjetet e nevojshme për të zbatuar politikën financiare. **[Kapitulli III, Standardi VI.2].**
- 2.7 Sikundër përmendet më sipër, Turgut Ozal Education sh.a. kryen një audit të jashtëm vjetor të situatës financiare nga shoqëria ndërkombëtare e auditit, Deloitte, dhe raporti i hollësishëm gjendet në zyrat kryesore të Turgut Ozal Education sh.a., si dhe në Universitet. Krahas kësaj, Turgut Ozal Education realizon një audit të brendshëm të Universitetit **(DVV)**. Raporti vjetor i auditit të jashtëm publikohet në faqen zyrtare të

Qendrës Kombëtare të Biznesit të Shqipërisë (<https://gkb.gov.al/home/>). Raportet financiare bëhen publike në Raportin Vjetor (38) dhe janë të disponueshëm për diskutim nga stafi dhe studentët. Raportet e auditit tregojnë se Universiteti po përmirëson efikasitetin dhe po rrit të ardhurat e krijuara nga tarifat e shkollimit, së bashku me pasqyrën e shpenzimeve dhe shpërndarjen e fitimeve nga burime të tjera, që paraqiten në Raportet Vjetore (38). Ndaj, Universiteti ndjek politikën e kontrollit buxhetor dhe financiar. **[Kapitulli III, Standardi VI.3].**

2.8 Zyra e Koordinimit të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit pranë Universitetit ka zhvilluar një sistem të integruar për menaxhimin e informacionit, që quhet Sistemi Ndërveprues Epoka (EIS) (DVV). Ky sistem përmban informacione për çështjet dhe shërbimet e studentëve, mësimdhënien dhe mësimnxënien, burimet njerëzore, menaxhimin financiar, dhe infrastrukturën (M9, DVV). Janë publikuar udhëzimet për përdorimin e këtij sistemi nga stafi (67) dhe studentët (68), të cilët e konsiderojnë shumë të efektshëm në dhënien e informacioneve të nevojshme (M3, M4, M6). Stafi dhe studentët duhet të hyjnë me një fjalëkalim dhe të marrin informacionet e nevojshme, si notat e studentëve (M3, M4), dhe kurset dhe lista e studentëve për stafin mësimdhënës (M6). Informacionet janë të aksesueshme për qëllime menaxhimi në vendimmarrje dhe për publikim në faqen zyrtare (<http://www.epoka.edu.al/>) dhe në Raportet Vjetore (38). Zyra e Koordinimit të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit bashkërendon EIS-në dhe iu jep informacione të gjithë personave që kanë nevojë (69). Informacionet, duke përfshirë të dhënat statistikore për numrin e studentëve për program, ofertat akademike, organizimin e Universitetit, dhe Statutin dhe Rregulloret, janë të disponueshme në Raportin Vjetor (38) dhe në faqen zyrtare të Universitetit (<http://www.epoka.edu.al/>). **[Kapitulli III, Standardi VII.1].**

2.9 **Sistemi Ndërveprues EPOKA (EIS), i zhvilluar nga Zyra e Koordinimit të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit, është shumë risiprurës dhe konsiderohet praktikë e mirë nga Grupi i Vlerësimit të Jashtëm. Universiteti e përdor teknologjinë e informacionit në mësimdhënie dhe mësimnxënie, kërkim, administrim dhe menaxhim.** Zyra e Koordinimit të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit kanë një plan strategjik shumë të qartë dhe të hollësishëm për periudhën 2018 - 2022 (70), që përfshin zhvillimet e parashikuara. Universiteti ka një total prej 360 kompjuterash, 172 prej të cilëve ndodhen në tre laboratorët kompjuterikë. Laboratorë dhe klasat janë të pajisur me akses në internet, 16 printerë, 16 fotokopje, 16 skanerë, dhe 30 videoprojektorë (DVV, 69, Turi). Burimet e ofruara nga Universitetit mundësojnë mësimnxënien e përzierë, por sigurisht për shkak të COVID-19, i gjithë procesi mësimor është zhvilluar përmes internetit, sipas politikave të Universitetit për ruajtjen e cilësisë (M12, 184). Të gjitha zyrat e stafit janë të pajisura me kompjutera me akses në internet dhe Wi-Fi në të gjitha godinat. Të gjitha klasat janë të pajisura me kompjutera dhe videoprojektorë, dhe/ose tabela inteligjente (smart board). Laboratorët kompjuterikë janë të pajisur me kompjutera cilësorë, që përmbushin kërkesat e programeve të ndryshme të studimit për burime të mira kompjuterike, si: Inxhinieria Kompjuterike, Arkitektura dhe Inxhinieria Civile, si dhe kanë licensat e kërkuara (71, DVV, Turi). **[Kapitulli III, Standardi VII.2].**

2.10 Pronat e Universitetit administrohen nga Turgut Ozal Education sh.a (72), të cilët janë përgjegjës për politikën mbi zhvillimin dhe mbrojtjen e tyre. Ka tri godina, dy prej të cilave përdoren për mësimdhënie, kërkim, dhe veprimtari jashtëkurrikulare, si dhe kanë një sipërfaqe totale prej 14,352m² (DVV, Turi). Universiteti ka një Master Plan për zhvillimin e pronës, që është pjesë e Strategjisë Kuadër të Universitetit 2018 -

2022 **(32)**. Universiteti është projektuar për të akomoduar 3,500 studentë, gjë që kërkon investime dhe zhvillim të mëtejshëm të infrastrukturës, sikundër përvijohet në Master Planin e Universitetit Epoka **(73)**. **[Kapitulli III, Standardi VII.3]**.

- 2.11 Universiteti ndjek një politikë për mbrojtjen dhe zhvillimin e trashëgimisë së pronave akademike, kulturore, dhe shkencore, çka rregullohet përmes Direktivës për Blerjet **(74)**, që përcakton autoritetin, përgjegjësitë, dhe procedurat në lidhje me ofrimin e të gjitha llojeve të mallrave dhe shërbimeve, qiranë dhe ndërtimin e hapësirave, që menaxhohen ose janë pronë e Universitetit. **Universiteti ka hapësira të shkëlqyera për mësimdhënie dhe mësimnxënie (75, Turi), dhe Grupi i Vlerësimit të Jashtëm gjykoj se zhvillimi i infrastrukturës dhe burimeve të përshtatshme për mësimdhënie dhe mësimnxënie, me qëllim mbështetjen e programeve të studimit, janë praktikë e mirë.** Informacionet pronëse të Sistemit Ndërveprues Epoka janë depozituar **(76)** dhe janë regjistruar **(77)** në Drejtorinë e Patentave dhe Markave të Republikës së Shqipërisë. Universiteti i mirëmban pronat e veta akademike, kulturore, dhe shkencore, sikundër tregohet në direktivën e bibliotekës **(78)**, dhe vlerat kulturore të Universitetit ruhen në laboratorë, bibliotekë, si dhe bankën digjitale që mban pronat akademike dhe shkencore të Universitetit **(DVV)**. **[Kapitulli III, Standardi VII.4]**.
- 2.12 Universiteti Epoka ka infrastrukturë të përshtatshme për të realizuar mësimdhënien dhe mësimnxënien, si dhe aktivitete të tjera **(75)**, që janë në përputhje me rregulloret e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale **(79)**, si dhe Ministrisë së Brendshme **(80)**. Edhe godinat janë në përputhje me standardet sa i përket ofrimin të hapësirave të mjaftueshme për stafin, duke përfshirë hapësirat për parkim, zyrat, mensën, dhe hapësirat argëtuese **(81, 82)**. Godinat e përdorura janë bashkëkohore dhe kanë mjetet e nevojshme për të kontrolluar temperaturën **(Turi)**. Ato janë të pajisura me të gjitha mjetet që përdoren në proceset moderne të mësimdhënies dhe mësimnxënies **(Turi)**, në përputhje me standardet e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit **(83, 88)**, sa i përket numrit të punonjësve dhe studentëve që i përdorin, duke përfshirë ashensorët **(75, Turi)**. Universiteti realizon anketa të rregullta të kënaqshmërisë së stafit dhe studentëve, me qëllim përmirësimin e punës sipas nevojës **(84)**. **[Kapitulli III, Standardi VII.5, VII.6]**.
- 2.13 Universiteti ndodhet në një zonë të gjelbër jashtë Tiranës, me një kampus që ka një sipërfaqe prej 67,000m² **(DVV)**. Ofron mjedise dhe infrastrukturë cilësore dhe të përshtatshme për aktivitetin akademik dhe shkencor të stafit, studentëve, dhe palëve të interesit, duke përfshirë klasat, laboratorët kompjuterikë, një laborator elektronik, një laborator të inxhinierisë civile, biblioteka, si dhe hapësira argëtuese dhe sportive **(Turi, 85)**. Mjediset pastrohen dhe mirëmbahen vazhdimisht, dhe një ekip teknikësh kujdeset për sistemin elektronik, ngrohjen, dhe ajrin e kondicionuar në të gjitha hapësirat **(Turi, DVV)**. Klasat kanë pajisje të përshtatshme për mësimdhënie dhe mësimnxënie, si: videoprojektorë, sisteme zëri, lidhje pa kablo, tabela inteligjente, dhe softuerët e duhur **(69, Turi)**. Së fundmi, biblioteka është pasuruar me 15,000 tituj të rinj **(86)**. **[Kapitulli III, Standardi V.1]**.
- 2.14 Godinat që përdoren për proceset e mësimdhënies dhe mësimnxënies kanë shkallë emergjence **(88, Turi)**, dhe kanë një sistem mbrojtjeje nga zjarri **(89)**. Krahas kësaj, Universiteti realizon një inspektim vjetor të sigurisë nga zjarri **(90)**, ndërsa trajnimi për sigurinë nga zjarri zhvillohet dy herë në vit nga specialistë të jashtëm **(91)**.

Universiteti ka edhe gjeneratorë energjie dhe një depozitë qendrore uji **(DVV)**. **[Kapitulli III, Standardi V.1].**

- 2.15 Rektorati i mban të gjitha kopjet në format të shtypur dhe digjital të të gjitha aktiviteteve akademike, duke përfshirë vendimet dhe procesverbalet e mbledhjeve të Rektoratit, Senatit Akademik, dhe Bordit Administrativ. Administratorët e Fakultetit e mbajnë të gjithë dokumentacionin në lidhje me Fakultetin, ndërsa Zyra e Regjistrimit e mban të gjithë dokumentacionin në lidhje me studentët **(M9)**. Në fund të çdo viti akademik, dokumentet transferohen pranë arkivës sipas rastit **(Turi)**. Sistemi Ndërveprues Epoka e ka lehtësuar procesin e ruajtjes së të dhënave digjitale, duke përfshirë regjistrimin e studentëve, sipas kërkesave ligjore **(69)**. Informacionet personale të studentëve mbahen në baza të sigurta të dhënash, së bashku me regjistrat e frekuentimit dhe notave. Informacionet e përgjithshme për programet e studimit, syllabuset, dhe kreditet janë të disponueshme në hapësirat përkatëse të departamenteve, në faqen zyrtare (<http://www.epoka.edu.al/>). **[Kapitulli III, Standardi V.2].**

Gjetje

Praktika e mirë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi karakteristikat e mëposhtme të praktikës së mirë:

- Sistemi Ndërveprues EPOKA (EIS), i zhvilluar në universitet nga Zyra e Koordinimit të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit, për t'u përdorur në mësimdhënie dhe mësimnxënie, kërkim, administrim dhe menaxhim (Pika 2.9). **[Kapitulli III, Standardi VII.2].**
- zhvillimi i infrastrukturës dhe burimeve të përshtatshme për mësimdhënie dhe mësimnxënie, me qëllim mbështetjen e programeve të studimeve (Pika 2.11). **[Kapitulli III, Standardi VII.4].**

Pikat e dobëta

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë dobësi.

Rekomandimet

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk dha asnjë rekomandim.

Konfirmimi i veprimit të ndërmarë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk bëri asnjë pohim.

Gjykimi

Standardet për Burimet janë përmbushur plotësisht.

Fusha e Vlerësimit 3: Kurrikula

- 3.1 Universiteti ofron 11 programe studimi në ciklin Bachelor, 8 në Master Shkencor, 6 në Master Profesional, 2 në Ciklin e Dytë të Integruar, dhe 6 në Doktoraturë **(18)**, dhe të gjitha këto programe janë në përputhje me strategjinë dhe misionin e tij, si dhe kërkesat e tregut. Hollësitë rreth kritereve të pranimit, kurrikulën, dhe syllabuset janë të disponueshme në faqen zyrtare të internetit (<http://www.epoka.edu.al/>). Universiteti i bën publike informacionet rreth programeve të studimit në faqen e tij të internetit, në llogaritë e tij në mediat sociale, si dhe në broshura dhe fletëpalosje promovuese **(50; 93)**. Studentët, me të cilët u takua Grupi i Vlerësimit të Jashtëm, konfirmuan se kanë akses në të gjitha informacionet e nevojshme rreth programeve që iu duhen **(M3, M4)**. **[Kapitulli I, Standardi I.1].**
- 3.2 Universiteti mban kontakt të vazhdueshëm me institucionet e arsimit të mesëm të lartë dhe organizon “javë orientimi”, vizita, dhe panairë pune, për t’iu dhënë nxënësve të shkollave të mesme informacione rreth programeve të studimit, kurrikulave, stafit akademik, dhe infrastrukturës **(M3; 95, 96, 97, 98, 99)**. Shumica e kurseve jepen në gjuhën angleze, ndaj kompetencat në këtë gjuhë specifikohen qartësisht **(94, 102)**. Profili i universitetit përfshin inxhinierinë, inxhinierinë kompjuterike, biznesin, shkencat sociale, dhe studime humane. Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Sociale ofron programe studimi në “Drejtësi” dhe “Shkenca Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare” **(101)**. **[Kapitulli I, Standardi I.1].**
- 3.3 Universiteti ka kuota, kritere dhe procedura pranimi të përcaktuara për studentët shqiptarë, shqiptarët nga rajoni, si dhe studentët e transferuar dhe të huaj **(M9, 101)**, në përputhje me kuadrin ligjore, rregulloret e institucionit **(102, 103, 104, 105)** dhe Strategjinë Kuadër të institucionit **(28)**. Programet e studimit që ofrohen nga Universiteti organizohen në mënyrë të tillë që bashkërendojnë të gjithë komponentët e tij. Të gjitha programet e studimit janë akredituar në nivelin kombëtar, ndërsa një program studimit është akredituar edhe nga një agjenci e huaj akreditimi, që është anëtare e plotë e ENQA-së **(106)**. **[Kapitulli I, Standardi I.1].**
- 3.4 Sipas Strategjisë Kuadër **(28)**, përmes Qendrës së Edukimit të Vazhdueshëm (QEV), Universiteti iu ofron kurse trajnimi afatshkurtra studentëve, stafit, dhe palëve të treta, në kontekstin e të nxënësve gjatë gjithë jetës, si dhe iu ofron një certifikatë në fund të kursit të trajnimit **(109)**. Programet e studimit në ciklin e dytë dhe të tretë organizohen dhe përshtaten sipas nevojave të kategorive të ndryshme të studentëve, si për shembull programet e Masterit që zhvillohen nga e hëna në të premte nga ora 18:00 deri në orën 20:45 **(DVV, fq. 40)**. **[Kapitulli I, Standardi I.2].**
- 3.5 Univesiteti ka politikën e tij “Për përmirësimin e vazhdueshëm të programeve të studimit” **(106)**, ku shkruhet se “*Universiteti Epoka vlerëson dhe përmirëson sistematikisht cilësinë e programeve të studimit, proceset, dhe shërbimet e tij për të arritur një nivel të lartë efikasitetit, efektshmërie, dhe kënaqshmërie të studentëve dhe palëve të interesit*”. Universiteti e rishikon performancën e programeve të studimit çdo vit. Studentët janë pjesë aktive e vlerësimit të programeve të studimit përmes diskutimeve me pedagogët dhe këshilluesin e studentëve rreth syllabuseve, anketave, ose vlerësimit të kursit me notë në fund të semestrit **(M4)**. Për të vlerësuar përvojën e përfutur, Universiteti ka përfshirë praktikën profesionale si modul të

detyruar në kurrikulat e të gjitha programeve të studimit, dhe e realizon sipas rregulloreve dhe udhëzimeve **(113, 114)** [Kapitulli I, Standardi I.2].

- 3.6 Universiteti ofron programe studimi në tri cikle që janë në pajtim me të gjithë komponentët e strategjisë së zhvillimit të institucionit **(28)** dhe strategjitë e departamenteve. Rezultatet e pritshme të programeve janë të përcaktuara qartësisht. Universiteti përdor Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS) krahas sistemit amerikan të orëve për kredite. Diplomat iu jepen studentëve të diplomuar së bashku me dokumentet përkatëse, si: suplementi i diplomës **116, 117)** [Kapitulli I, Standardi I.3].
- 3.7 Programet e studimit që ofrohen nga Universiteti janë në përputhje me nivelin e kërkuar të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve **(118)** dhe me transparencë për transferimin e studentëve dhe punëdhënësit **(119)**. Universiteti ndjek një politikë të qartë për të garantuar koherencë në programet e studimit. Programet rishikohen vazhdimisht, duke filluar me departamentet, duke marrë parasysh rezultatet e studentëve, si dhe gjetjet e anketës së alumnive **(120, 121)**, dhe vendimi përfundimtar merret nga Senati Akademik **(106)**. Përqindja e punësimit të studentëve të diplomuar është e lartë **(38)** dhe punëdhënësit, që u takuan me Grupin e Vlerësimit të Jashtëm, u shprehën se ishin shumë të kënaqur me cilësinë dhe aftësitë komunikuese të studentëve të Universitetit Epoka **(M7)**.
- 3.8 Universiteti e ka përgatitur axhendën e ndërkombëtarizimit duke nxitur bashkëpunimin dhe partneritetin strategjik me universitete perëndimore, si: Universiteti i Salernos në Itali **(M7)**, si dhe me sektorin publik dhe bizneset. **(28)**. Thujse në të gjitha programet e studimit, mësimi jepet në gjuhën angleze, por Universiteti promovon edhe të mësuarit e gjuhëve të huaja, si: frëngjishtja, gjermanishtja, turqishtja, dhe italishtja, të cilat i ofron si kurse me zgjedhje në programet Bachelor. Stafi i huaj akademik jep mësim në disa kurse. **Universiteti Epoka ofron diploma të përbashkëta me Universitetin e Shkencave të Aplikuara, në Mainz, Gjermani (M7).** [Kapitulli I, Standardi I.4].
- 3.9 Ngarkesa mësimore e lektorëve përcaktohet në përputhje me kriteret e parashikuara nga aktet nënligjore në fuqi, rregulloren e Universitetit **(57)**, si dhe në përputhje me kapacitetet e burimeve njerëzore **(122)**. Ngarkesa mësimore shtesë financohet nga burimet e Universitetit **(124)**. Stafi akademik e konfirmoi mbështetjen financiare nga Universiteti për orët mësimore shtesë **(M6)**. Ngarkesa mësimore i jep mundësinë stafit akademik që të realizojë detyrat e veta kërkimore dhe administrative, si: pakësimi i numrit të orëve mësimore, **çka adreson rekomandimin e vlerësimit të jashtëm të mëparshëm (46),** [Kapitulli I, Standardi I.5].
- 3.10 Universiteti ka ngritur një sistem ndërveprues ku studentët mund të hyjnë dhe të kontrollojnë të gjitha informacionet që iu nevojiten **(M3)**. Gjatë vizitës u mësua se departamentet organizojnë mbledhje vjetore me studentët e mëparshëm, studentët e Masterit Shkencor, alumnit, pedagogët, dhe dekanët, për t'iu ofruar një tablo të plotë studentëve të saporegjistruar rreth sistemeve të mësimnxënies, vlerësimit, vlefësimit, etj. Studentët u shprehën se këto mbledhje ishin shumë të dobishme për ta **(M3)**. Studentët, me të cilët u takua Grupi i Vlerësimit të Jashtëm, konfirmuan se kriteret e pranimit, përmbajtja e programeve, dhe objektivat e të nxënies ishin të qarta për ta **(M3, M4)**. Në fillim të çdo viti akademik, gjatë seancave të orientimit, studentët

e saporegjistruar orientohen rreth programeve të tyre përkatëse **(125)**. *[Kapitulli I, Standardi I.6].*

- 3.11 Programet e ciklit të parë janë me kohë të plotë, në përputhje me procesin e Bolonjës **(13)**, dhe synojnë t'iu ofrojnë studentëve njohuritë, parimet shkencore, si dhe aftësitë dhe kompetencat profesionale, duke lejuar procesin e kalimit nga cikli i parë tek i dyti. Programet e studimit përfshijnë module me detyrim dhe me zgjedhje, dhe ofrojnë formim profesional, duke iu mundësuar studentëve të diplomuar integrim në tregun e punës. Studentët e ciklit të parë informohen, veçanërisht nga këshilluesi personal i studentëve, gjatë dhe në fund të studimeve të tyre, rreth mundësive të punësimit me diplomën që marrin **(M3)**. Programet e studimit sigurojnë përfundimin e suksesshëm të ciklit të parë dhe pranimin në ciklin e dytë **(117)**. Studentët informohen dhe orientohen rreth mundësisë së transferimit të programeve të studimit ose krediteve që kanë marrë gjatë studimeve të tyre **(127)**. *[Kapitulli I, Standardi I.7].*
- 3.12 Universiteti i mbështet studentët duke filluar me javën e orientimit **(125)**, dhe më pas gjatë studimeve të tyre përmes këshilluesve personalë të studentëve **(102, M3, M4)**, Zyrës së Dekanit të Studentëve, Zyrës së Regjistrimit, Koordinatorëve të Departamentëve, zyrës së TI-së, stafit të bibliotekës, si dhe Udhëzuesit Inteligent të Studentëve **(107)**. Përdoren metoda alternative mësimdhënieje, metoda të ndryshme mësimdhënieje dhe vlerësimi, duke përfshirë metodat tradicionale dhe me në qendër studentin të mësimdhënies **(102, 103)**, të cilat mbështeten nga disa laboratorë **(Turi)**. Studentët, me të cilët u takua Grupi i Vlerësimit të Jashtëm, ishin të kënaqur me mjediset e të nxëniet elektronik gjatë situatës së pandemisë **(M3, M4)**. **Mbështetja individuale që jepej nga këshilluesit e studentëve në nivelin e kurseve duke monitoruar dhe duke mbështetur ecurinë dhe arritjet e studentëve është shembull i praktikës së mirë.** Universiteti rekruton me prioritet stafin akademik, që ka një numër të lartë botimesh shkencore dhe pjesëmarrje aktive në projekte **(129)**. Stafi akademik me kohë të plotë mbulon më shumë se 87% të ngarkesës mësimore të programeve të studimit **(182)**. *[Kapitulli I, Standardi I.8].*
- 3.13 Anëtarët e stafit akademik që japin mësim në programet e studimit të ciklit të dytë kanë të paktën një titull PhD **(103)**, si dhe marrin pjesë në mënyrë aktive në aktivitete kërkimore **(129)**. Ata përgatitin një raport vjetor rreth ecurisë së tyre, të cilin ia paraqesin Departamentit përkatës **(M6, M10)**. Stafi akademik merr pjesë në hartimin, projektimin dhe rishikimin e programeve të studimit, si dhe në përditësimin dhe zbatimin e kurrikulës, sipas një procedure të mirëpërcaktuar **(112)**. Teza e Masterit Shkencor dhe praktika profesionale zhvillohen në bashkëpunim me sektorin privat dhe ndërmarrje shtetërore, nën mbikëqyrjen dhe udhëheqjen e stafit akademik, i cili bën vlerësimin përfundimtar **(113, 114, 134)**. Universiteti mbledh rregullisht të dhëna statistikore për punësimin e studentëve të diplomuar, sipas një programi gjurmimi. Këto të dhëna publikohen në raportet vjetore **(38)**. Në proceset e mësimdhënies dhe kërkimit në programet e studimit të Masterit Profesional, Universiteti përfshin edhe përfaqësues të punëdhënësve nga biznesi ose industria **(182, 136)**. Stafi akademik me kohë të plotë mbulon më shumë se 90% të ngarkesës mësimore të programeve të studimit **(182)**. *[Kapitulli I, Standardi I.9].*
- 3.14 Programet e studimit ofrohen në përputhje me Procesin e Bolonjës, sa iu përket cikleve të sistemit: Bachelor, Master, Doktoraturë **(13, 185)**. Të gjitha programet e studimit ofrohen me kohë të plotë dhe organizohen në module me kredite, sipas ECTS-së. Të gjitha informacionet e nevojshme në lidhje me kurrikulën, syllabuset,

dhe programet janë të disponueshme edhe në gjuhën angleze në hapësirat përkatëse të Departamenteve në faqen zyrtare të Universitetit. Diplomat jepen në përfundim të programeve të studimit të ciklit të parë, ciklit të dytë, ose ciklit të integruar **(116)**, dhe shoqërohen me një suplement/shtojcë diplome (117) në gjuhën angleze dhe shqipe, në një format që duhet miratuar nga organet drejtuese të Universitetit dhe qeveria, sipas kuadrit ligjor. **Thujse të gjitha programet e studimit ofrohen në gjuhën angleze dhe janë projektuar në mënyrë të tillë që lehtësojnë mobilitetin e studentëve në Zonën Evropiane të Arsimit të Lartë (EHEA) dhe më tej.** Për këtë arsye, kompetencat në gjuhën angleze janë një kriter pranimi shtesë për të gjitha programet e studimit (102, 103). Studentëve iu duhet që ose të paraqesin një certifikatë të njohur ndërkombëtarisht të gjuhës angleze për të gjitha nivelet e programeve të studimit, ose të bëjnë një provim të gjuhës angleze që organizohet nga Universiteti, sipas testeve ndërkombëtare **(102, 104)**. Të mësuarit e gjuhëve të huaja është në përputhje me politikën e Universitetit për ndërkombëtarizim. Kreditet e dhëna në një Institucion të huaj partner të Arsimit të Lartë, në kuadër të një marrëveshjeje të ndërsjellë, njihen mbështetur në miratimin përfundimtar të Dekanatit të Fakultetit **(13, 105)**. Studentët folën për mundësitë e mobilitetit, të cilat aktualisht ishin të kufizuara për shkak të pandemisë. Universiteti ka një sistem vlerësimi me notë **(38, 102)**, që ndihmon në lehtësimin e transferimit të studentëve dhe krediteve. **[Kapitulli I, Standardi 1.10].**

- 3.15 Programet e studimit përfshijnë punë praktike, që mundëson përvetësimin e aftësive praktike. Praktika profesionale është një modul me detyrim në të gjitha programet e studimit, dhe është e suksesshme falë bashkëpunimit midis Universitetit dhe bizneseve e shoqërive **(M3, M4, M7)**. Të gjitha kurrikulat organizohen në ECTS, dhe modulet vlerësohen në ECTS. Secili vit akademik ka 60 ECTS **(13)**.
- 3.16 Në të gjitha programet e studimit, studentët ndërmarrin përgatitjen dhe paraqitjen e projekteve të kërkimit shkencor, detyrave, eseve, dhe prezantimeve, që parashikohen në syllabuset e moduleve, duke përfshirë edhe përqindjet përkatëse të çdo komponenti vlerësimi. Në bashkëpunim me Këshillin Studentor, Klubin e Studentëve, dhe Zyrën e Aktiviteteve, organizohen aktivitete kulturore dhe edukuese, si: evenimente sportive, forume të hapura, festa e pranverës, apo klubet studentore. **(42, 12). (Kapitulli I, Standardi 1.11)**
- 3.17 Programet e studimit integrojnë aftësitë teorike dhe praktike (143). Programet e studimit përfshijnë praktikat profesionale dhe stazhet nën orientimin e udhëheqësve, çka i ndihmon studentët të përvetësojnë aftësi praktike. Studentët, me të cilët u takua Grupi i Vlerësimit të Jashtëm, ofruan shembuj të praktikave që zhvillohen në shoqëri të ndryshme **(M3, M4, 135)**. Universiteti ka shumë marrëveshje me shoqëritë e sektorit privat, si: Intesa Sanpaolo Bank, Deloitte dhe Vodafone. Përfaqësuesit e disa prej këtyre shoqërive, me të cilët u takua **(M7)** Grupi i Vlerësimit të Jashtëm, u shprehën se ishin të kënaqur me kompetencat profesionale të studentëve. Ata treguan rreth studentëve të diplomuar në Universitetin Epoka, që ishin punësuar në shoqëritë e tyre. Krahas kësaj, Universiteti punëson edhe disa nga studentët e tij si ndihmës pedagogë, që i ndihmojnë profesorët gjatë orëve praktike **(M6)**. **Grupi i Vlerësimit të Jashtëm gjykoi se sistemi i stazheve që organizohen nga Universiteti, duke iu ofruar studentëve një larmi mundësish punësimi, çka mbështet zhvillimin e punësueshmërisë së studentëve, është praktikë e mirë. [Kapitulli I, Standardi 1.12].**

Gjetje

Praktika e mirë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi karakteristikat e mëposhtme të praktikës së mirë:

- diplomat e dyfishta me Universitetin e Shkencave të Aplikuara, në Mainz, Gjermani **[Pika 3.8, Kapitulli I, Standardi I.4].**
- mbështetja individuale që jepej nga këshilluesit e studentëve në nivelin e kurseve duke monitoruar dhe duke mbështetur ecurinë dhe arritjet e studentëve **[Pika 3.12, Kapitulli I, Standardi I.8].**
- ofrimi i programeve në gjuhën angleze, çka promovon mobilitetin e studentëve në Shqipëri dhe në mbarë botën **[pika 3.14, Kapitulli I, Standardi I.10].**
- sistemi i stazheve që organizohen nga Universiteti, duke iu ofruar studentëve një larmi mundësish punësimi, çka mbështet zhvillimin e punësueshmërisë së studentëve **[Pika 3.14, Kapitulli I, Standardi I.12].**

Dobësitë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë dobësi.

Rekomandimet

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk dha asnjë rekomandim.

Konfirmimi i veprimit të ndërmarë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk bëri asnjë pohim.

Gjykimi

Standardet për Kurrikulën janë **përbushur plotësisht.**

Fusha e Vlerësimit 4: Mësimdhënia, Mësimnxënia, Vlerësimi dhe Kërkimi

- 4.1** Programet studimore mbështeten në kuadrin ligjor, dhe përgjegjësitë për organizimin e tyre parashikohen në rregulloret e programeve (**102, 103, 104**). Kurrikulat e programeve të studimit dhe syllabuset e moduleve publikohen në faqen zyrtare të Universitetit dhe arkivohen në njësit përgjegjëse (**143**). Departamentet rishikojnë programet e studimit çdo vit dhe propozojnë ndryshimet e nevojshme, që më pas miratohen nga Senati Akademik. Planet mësimore miratohen nga çdo Fakultet (**57, 182**). Universiteti ka kapacitete të mjaftueshme për praktikë në laboratorë (**75**), ose për stazh në sektorin privat dhe publik përmes rrjeteve të partneritetit (**182**). Studentët orientohen dhe mbikëqyren nga një lektor gjatë praktikës, stazhit, dhe punës kërkimore, në përputhje me procedurat specifike. Universiteti ka një bibliotekë me 25,000 libra të shtypur dhe burime interneti (**87**). *[Kapitulli I, Standardi II.1].*
- 4.2** Rregullat dhe kërkesat e provimeve paraqiten në rregulloret e çdo programi studimi (**3**), që janë publike. Studentët informohen përmes email-it ose i gjejnë informacionet në faqen e internetit, ku publikohen edhe kriteret dhe procedurat e diplomimit. Gjatë vlerësimit të provimeve respektohet anonimati përmes një sistemi të dedikuar (**DVV, fq. 56, 146, 147**). Ankesat për pikët dhe procedurat e provimeve specifikohen në rregulloren e provimeve dhe në Udhëzuesin e Studentëve (**107**). Studentëve iu jepet një llogari personale, që lehtëson regjistrimin e tyre në të gjitha kurset e studimit, si dhe iu mundëson akses në notat e provimeve të tyre, duke ruajtur parimin e konfidencialitetit. Zyra e Koordinimit të TIK-ut ka zhvilluar një sistem të automatizuar, që quhet Sistemi Ndërveprues Epoka (EIS). *[Kapitulli I, Standardi II.2].*
- 4.3** Programet e studimit dhe lektorët vlerësohen çdo vit përmes strukturave të Universitetit. Universiteti merr komente nga stafi akademik dhe studentët për t'u siguruar që mësimdhënia dhe mësimnxënia janë cilësore (**120**). Stafi akademik dhe programet e studimit vlerësohen nga studentët përmes një ankete. Grupi i Vlerësimit të Jashtë u informua nga studentët, që ata plotësojnë një anketë në fund të semestrit. Kjo anketë lidhet me përmbajtjen e kursit, performancën e pedagogëve, dhe shërbimet e ofruara nga Universiteti (**M3, M4**). Studentët mund t'i shprehin lirisht mendimet e tyre dhe të vlerësojnë me notë pedagogët dhe metodat e mësimdhënies. Anketa e alumnive dhe Anketa e Kënaqshmërisë së Shoqërisë (**121**) organizohen nga Zyra e Planifikimit të Karrierës dhe Studentëve të Diplomuar për të marrë komente rreth kompetencave të përfuara nga programi i studimit. Performanca e studentëve, si përqindja e kalimit dhe të dhënat e mësimdhënies, vlerësohen çdo vit. Të gjitha rezultatet e sipërpërmendura publikohen në Raportet Vjetore (**38**). Programet e studimit rishikohen çdo vit, kurrikulat përditësohen nga njësitë bazë dhe paraqiten për miratim pranë Senatit Akademik (**106**) *[Kapitulli I, Standardi II.3].*
- 4.4** Departamentet dhe njësia e sigurimit të brendshëm të cilësisë janë përgjegjëse për monitorimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve përkatëse të studimit (**13**). Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në Universitet përbëhet nga disa nën-njësi (**182**), që ushtrojnë veprimtarinë e tyre sipas rregulloreve (**148**). Universiteti ka laboratorë që mbështetin mësimdhënien dhe ka organizuar aktivitete të vazhdueshme trajnimi (**52**) për të përmirësuar mësimdhënien. Stafit akademik i jepet mbështetje financiare për të marrë pjesë në konference, për të botuar shkrime në buletine ndërkombëtare, si dhe për t'u angazhuar në projekte kërkimore (**149, M6, M10**). Stafi akademik përfshihet në mobilitet për mësimdhënie dhe trajnim nëpërmjet programit Erasmus + (**54**). Universiteti është përgjegjës për cilësinë e mësimdhënies. Universiteti i përdor anketën e studentëve (**84**) dhe anketën e stafit akademik për të vlerësuar burimet e të nxënit. Procesi i mësimnxënies lehtësohet nga infrastruktura e nevojshme, si: biblioteka (**87**), laboratorët elektronikë, dhe mjediset kompjuterike (**69**). Universiteti përdor metoda të të nxënit elektronik dhe burime në internet, që

janë shumë të efektshme, sidomos gjatë vitit të pandemisë, dhe studentët janë shumë të kënaqur me aplikimin e këtyre metodave (**M3, M4**). Universiteti sigurohet se stafi i rekrutuar akademik ofron cilësi në kërkimin shkencor (**182, M10**), dhe organizon trajnim dhe workshop-e të ndryshme për stafin akademik dhe administrativ. **[Kapitulli I, Standardi II.4]**.

- 4.5 Departamentet janë njësitë bazë të mësimdhënies dhe kërkimit, dhe përfshijnë grupe kërkimore homogjene që organizohen në fusha specifike kërkimi (**186**). Departamentet vlerësojnë kërkimet dhe raportet që përgatiten çdo vit nga çdo anëtar i stafit akademik në lidhje me aktivitetin kërkimor, të cilat më pas pikëzohen nga Rektorati. Çdo vit, Rektorati vendos vlerën e shpërblimit për stafin akademik bazuar në pikët e mbledhura (**41**). Stafi akademik, sidomos punonjësit e rinj dhe doktorantët, përfitojnë mbështetje financiare për të marrë pjesë në konferenca dhe aktivitete shkencore. (**41, M6, M10**). Universiteti organizon dhe bashkorganizon konferenca ndërkombëtare dhe aktivitete shkencore, si dhe ofron mbështetje financiare për projektet kërkimore që zhvillohen nga stafi akademik. **[Kapitulli II, Standardi I.1]**.
- 4.6 Zyra e Kërkimit dhe Projekteve të Universitetit mbështet kërkimin shkencor dhe trajnimin e stafit sipas rregulloreve (**28, 55, 41, 154**). Universiteti ka ngritur tri qendra kërkimore funksionale, sikundër përshkruhet në detaje (**DVV, fq. 64**). Universiteti garanton bashkëpunimin e strukturave kërkimore brenda dhe midis institucioneve, ka nënshkruar marrëveshje dypalëshe me universitete të tjera, si dhe merr pjesë në disa programe ndërkombëtare, si: COST action, Erasmus + dhe Horizon 2020 (**156**). Universiteti bashkëpunon me sektorin publik dhe privat për kryerjen e kërkimeve shkencore, projekteve, dhe stazheve të studentëve (**M7**). **[Kapitulli II, Standardi I.2]**.
- 4.7 Universiteti është aktiv në organizimin dhe pjesëmarrjen në konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare, në kuadër të planeve dhe politikave strategjike (**28**). Universiteti gjithashtu ka laboratorë të ndryshëm që përdoren në procesin e mësimdhënies (**Turi**). Universiteti ka nënshkruar 52 marrëveshje partneriteti me institucione të tjera të arsimit të lartë nga vende të ndryshme, si dhe merr pjesë në disa projekte ndërkombëtare (**156, 187**). Stafi i Universitetit ka botuar rreth 158 punime kërkimore në buletine ndërkombëtare që prej vitit 2017 (**129**), dhe lista e tyre është publikuar në faqen zyrtare të Universitetit. Organizohen gjithashtu edhe takime ceremoniale për arritjet në fushën kërkimore, si dhe takime ku stafi akademik paraqet kërkimet dhe mbron tezat e doktoraturës. **[Kapitulli II, Standardi I.3]**.
- 4.8 Departamentet kanë krijuar fusha kërkimore në përputhje me legjisllacionin, rregulloret, dhe strategjitë kombëtare dhe ndërkombëtare (**152, 153, 28**). Universiteti kujdeset që të mbrojë të drejtat e autorit, sikundër paraqitet në libërthrin me titull "Udhëzues i Stafit" (**49**). Universiteti gjithashtu organizon leksione të hapura, forume të hapura, dhe takime ceremoniale që nxisin debat shkencor në fushat parësore të kërkimit shkencor. **[Kapitulli II, Standardi I.4]**.
- 4.9 Universiteti monitoron proceset e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, si dhe raportet e brendshme dhe të jashtme për programet e studimit, që publikohen në faqen e internetit. Rekrutimi i stafit orientohet drejt studiuesve me përvojë, mbështetur në aftësitë e tyre kërkimore sipas rregulloreve (**43**), përmes një procesi të hapur dhe transparent që realizohet sipas një procedure specifike (**DVV, fq. 67, M10**). Universiteti zbaton politika prioritare që janë zhvilluar në fushat kërkimore, si dhe ka përgatitur një strategji kuadër (**28**). **[Kapitulli II, Standardi I.5]**.
- 4.10 Inxhinieria, projektimi, biznesi, drejtësia, dhe shkencat sociale janë disa nga fushat prioritare të Universitetit. Stafi akademik përfiton mbështetje financiare dhe administrative për të aplikuar në projekte kërkimore kombëtare dhe ndërkombëtare

përmes agjencive, si: NACRI, Fondi i Ballkanit Perëndimor, Visegrad dhe Komisioni Evropian. Doktorantët integrohen në grupe të kërkimit shkencor, ku kryejnë kërkimet e tyre sipas fushave kërkimore dhe kapaciteteve të Departamenteve. Studiuesit e rinj dhe doktorantët përfshihen në projekte kërkimore, që mbështeten financiarisht sipas udhëzimeve specifike **(154)**. Universiteti përfshihet në hartimin dhe zbatimin e politikave shkencore rajonale dhe kombëtare. Ka edhe shembuj të anëtarëve të stafit, që përfshihen individualisht në hartimin e strategjive kombëtare **(DVV)**. Në Universitet, 29% e stafit akademik dhe kërkimor është i huaj dhe vjen nga vende të ndryshme, si: SHBA, Mbretëri e Bashkuar, Rusi, Francë, Itali, Gjermani, Maqedoni e Veriut, Greqi, Kosovë, Turqi, Azerbajxhan, Indonezi, dhe Pakistan. Që prej vitit 2017 janë ftuar 47 lektorë ose studiues të huaj **(28)**. Universiteti nxit mobilitetin e stafit akademik, që angazhohet në kërkim shkencor, duke mbështetur pjesëmarrjen në aktivitete ndërkombëtare, si: seminare dhe konferenca, në përputhje me strategjinë dhe rregulloret institucionale. **(28, 55, 159, 41)**. *[Kapitulli II, Standardi I.6].*

- 4.11** Tri qendrat kërkimore të Universitetit (QSE, QKPSHA, QYBZQ) kanë organizuar seminare ndërkombëtare dhe simpoziume shkencore, sikundër tregohet në faqen zyrtare (<http://conf.epoka.edu.al>; <http://eco.epoka.edu.al/news-4th-international-virtual-conference-on-economics-and-development-a-iced-2020-5423.html>). Universiteti ofron mbështetje financiare për pjesëmarrjen e stafit akademik, dhe sidomos të stafit të ri, në aktivitete shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare. Universiteti ka një kuadër rregullator për aktivitetet e votimit: EU-DIR-004-EN/2009 "Për promovimin e botimeve shkencore" dhe EU-REG-013-EN/2007 "Rregullimi i Botimeve", si dhe ka zhvilluar një bankë digjitale ku ngarkohen rezultatet kërkimore. Të gjitha botimet e stafit akademik vlerësohen çdo vit nga një Juri e veçantë, sikundër përshkruhet në rregulloren "Për promovimin e botimeve shkencore" **(M6)**. Universiteti boton dy revista shkencore: Revista e Kërkimit Sociale Evropian dhe Revista Ndërkombëtare e Statistikave të Aplikuara dhe Ekonomiksit, në bashkëpunim me Shoqërinë Ekonomike të Shqipërisë. Mbështetur në të dhënat nga baza SCOPUS, Universiteti renditet si universiteti me numrin më të madh të kërkimeve shkencore nga universitete jopublike, dhe një nga pesë universitetet më të mira sa iu përket produkteve kërkimore **(173)**. *[Kapitulli II, Standardi I.7].*
- 4.12** Zyra e Kërkimit dhe Projekteve bashkërendon përdorimin e efektshëm të burimeve të Universitetit. Punimet shkencore të stafit akademik vlerësohen çdo vit nga një komision i posaçëm pranë Rektoratit, sipas rregullores **(41)**. Universiteti nxit mbrojtjen e pronësisë intelektuale. Të gjitha dokumentet që përgatiten nga studentët dhe stafi akademik i nënshtrohen testimit të plagjiaturës, që realizohet nga një softuer i posaçëm. Të gjitha tezat e mbrojtura të Masterit apo Doktoraturës publikohen në faqen zyrtare të Universitetit. Universiteti nxit botimin e shkrimeve nga stafi akademik **(188)**, veçanërisht në revista shkencore, që indeksohen në Rrjetin e Shkencës Clarivate, Elsevier' Scopus **(189)**. *[Kapitulli II, Standardi 1.8].*

Gjetje

Praktika e mirë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë karakteristikë të praktikës së mirë.

Pikat e dobëta

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë dobësi.

Rekomandimet

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk dha asnjë rekomandim.

Konfirmimi i veprimit të ndërmarrë.

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk bëri asnjë pohim.

Gjykimi

Standardet për Mësimdhënien, Mësimnxënien, Vlerësimin dhe Kërkimin janë **përbushur plotësisht.**

Fusha e Vlerësimit 5: Studentët dhe Mbështetja e tyre

- 5.1 Procedurat e pranimit të studentëve janë në përputhje me politikat e Universitetit (28, 93). Universiteti ka lidhur marrëdhënie me Drejtoritë Arsimore Rajonale dhe Zyrat Arsimore, dhe organizon vizita në shkollë për t'iu ofruar nxënësve të shkollave të mesme informacione rreth programeve të studimit (94). Procedurat e pranimit bashkërendohen nga Zyra e Pranimeve (174), me mbështetjen e stafit akademik (97, 98). Çdo vit, Universiteti merr pjesë në Painirin e Punës dhe Studimit, që organizohen nga Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë në Tiranë, ku studentët e ardhshëm informohen rreth programeve të studimit. Informacione dhe hollësi të tjera, si: kriteret e studimit dhe mundësitë për bursa, janë të disponueshme në faqen e internetit (50). Universiteti aplikon një skemë të bursave bazuar në meritë për studentët e programeve të studimit në të gjitha nivelet. Studentëve iu ofrohen Udhëzuesi i përvitshëm i Studentëve (107). Gjithashtu, organizohet një program mikpritës dhe një Ditë Orientimi, që ndihmon integrimin e lehtë të studentëve. Raportet staf/student i përmbushin kërkesat ligjore (190). Studentët e Masterit Shkencor punësohen si ndihmës pedagogë, çka i bën pjesë të kategorisë së “stafit akademik me kohë të pjesshme”, dhe mbështetin pedagogët (175, M10). **[Kapitulli I, Standardi III.1].**
- 5.2 Zyra e Planifikimit të Karrierës dhe Studentëve të Diplomuar është përgjegjëse për informimin dhe këshillimin e studentëve. Të gjithë punonjësit dhe studentët kanë një adresë email-i të brendshme (140), që përdoret për komunikimin e brendshëm. Gjithashtu, ata përdorin edhe mjete të jashtme komunikimi, si: radioja, televizioni, gazetatat, lajmet dhe intervistat (162, 163). Universiteti mban dosje personale për çdo student, në përputhje me legjislacionin (140). Zyra e Regjistrimit dhe këshilluesi akademik i studentëve mbajnë informacionet personale të studentëve, si: adresa fizike, adresa e email-it, dhe numri i telefonit. **[Kapitulli I, Standardi III.2].**
- 5.3 Çdo studenti i caktohet një këshillues personal. (M3, M4). Zyra e Marrëdhënieve Ndërkombëtare, Zyra e Planifikimit të Karrierës dhe Studentëve të Diplomuar, si dhe Zyra e Dekanit të Studentëve iu ofrojnë studentëve lloje të ndryshme informacioni, si: programet e shkëmbimit, mundësitë e punësimit, forumet e hapura (165), si dhe panairët e karrierës. Gjatë vizitës së Grupit të Jashtëm të Vlerësimit, studentët u shprehën se ishin shumë të kënaqur me mbështetjen e ofruar nga këshilluesit e tyre dhe me informacionin e mundësuar nga zyrat përkatëse (M3, M4). Udhëzuesi i Studentëve, broshurat, dhe fletëpalosjet janë të gjithanshme dhe të dobishme. Në faqen e internetit ofrohet informacion i hollësishëm për programet e studimit në të gjitha nivelet. Rregulloret dhe procedurat për transferimin e studentëve dokumentohen në direktivën “Për transferimin e studentëve” (105). **[Kapitulli I, Standardi III.3].**
- 5.4 Universiteti është angazhuar që të ofrojë mjedise të përshtatshme fizike për studentët me aftësi të kufizuara (166), dhe bursa për studentët nga komuniteti rom dhe egjiptian i Ballkanit (177). Bursat ofrohen për kategori të ndryshme studentësh, si p.sh ata që angazhohen në aktivitete sportive të nivelit të lartë; fëmijët jetimë të oficerëve të Policisë së Shtetit të vrarë në krye të detyrës; fëmijë jetimë që vijnë nga familje me të ardhura të ulëta (DVV, fq. 79), studentët me pikë të larta GPA dhe studentët me rezultate të larta, që diplomohen nga shkollat e mesme të bashkisë së Vorës, që është njësi e qeverisjes vendore ku ndodhet kampusi i Universitetit (161). **Grupi i Vlerësimit të Jashtëm gjykon se ofrimi i gjerë i bursave për studentët e disavantazhuar është karakteristikë e praktikës së mirë.** Programet e studimit të nivelit të dytë programohen në mënyrë të tillë që mbështetin studentët e punësuar me kohë të plotë. **[Kapitulli I, Standardi III.4].**

- 5.5 Biblioteka e Universitetit ka rreth 25,000 libra të shtypur. Studentët dhe stafi kanë akses në bibliotekën online JSTOR dhe në revista akademike. Universiteti parashikon në buxhetin e tij vjetor zëra për bibliotekën, që përfshijnë blerjen e librave sipas nevojave të departamenteve **(179, 86)**. Biblioteka ofron literaturë shumëdisiplinore dhe oraret e punës publikohen në faqen e internetit. Të gjithë studentët e regjistruar marrin kartën e studentit dhe regjistrohen në bazën e të dhënave të bibliotekës për të aksesuar literaturën **(180)**. *[Kapitulli I, Standardi III.5].*
- 5.6 Udhëheqja dhe mentorimi për studentët ofrohet gjatë vitit akademik nga këshilluesit akademikë, Zyra e Dekanit të Studentëve, si dhe nga stafi akademik. **(181)**. Studentëve iu ofrohen mbështetje nga bibliotekari **(78)** dhe nga pedagogët në shkrim akademik dhe metoda kërkimi. Programet e udhëheqjes organizohen për t'i ndihmuar studentët në vështirësi. *[Kapitulli I, Standardi III.6].*
- 5.7 Studentët përfaqësohen në organet kryesore qeverisëse të Universitetit, duke përfshirë Senatin, Këshillat e Fakulteteve, Bordin e Etikës, Komisionin e Përhershëm të Njësisë së Sigurimit të Cilësisë, dhe Komisionin e Përhershëm për Marrëdhëniet me Studentët **(13)**, dhe nxiten që të angazhohen në vendimmarrje **(M3, M4)**. Këshilli Studentor përbëhet nga përfaqësues të zgjedhur nga të gjitha programet. Këshilli Studentor shpreh mendime dhe bën propozime për të gjitha probleme me interes të përgjithshëm, si: planet mësimore, programet kërkimore, dhe rregulloret e studimit. Këshilli Studentor përfiton mbështetje financiare dhe ka infrastrukturën e nevojshme për aktivitetet e veta. Studentët gjithashtu përfitojnë mbështetje në aktivitete jashtëkurrikulare **(58)**. *[Kapitulli I, Standardi III.7].*
- 5.8 Universiteti nxit aktivitetet sportive **(142)**, si dhe ofron mbështetje financiare për aktivitetet sportive dhe kulturore. **Ka 22 klube studentore aktive (60)**, të cilat në bashkëpunim me Dekanin e Zyrës Studentore, organizojnë aktivitete **(12)**, si: forume, workshop-e, dhe programe trajnimi **ku iu japin certifikata pjesëmarrësve dhe organizatorëve (168) ose ndajnë çmime në konkurse kulturore dhe edukuese**. Klubet studentore ftojnë ekspertë të shquar nga fusha të ndryshme për të dhënë leksione të hapura, duke ofruar kështu një jetë aktive sociale dhe edukuese për studentët **(61)**. Studentët gjithashtu nxiten që të marrin pjesë në aktivitete kulturore. **Grupi i Vlerësimit të Jashtëm mendon se ofrimi i klubeve studentore dhe aktiviteteve sportive është një karakteristikë e praktikës së mirë**. Universiteti ka një ekip futbollit meshkujsh dhe një ekip volejbollit femrash, që luajnë në kampionate të ndryshme, dhe studentët e talentuar e kanë përfaqësuar Shqipërinë në disa prej konkurseve më të rëndësishme ndërkombëtare sportive **(DVV, fq. 83)**. Kujdesi mjekësor iu ofrohet edhe studentëve edhe stafit akademik me kohë të plotë **(DVV, fq. 83)**. *[Kapitulli I, Standardi III.8].*
- 5.9 Zyra e Alumnit dhe e Planifikimit të Karrierës është përgjegjëse për ndjekjen e punësimit të të diplomuarve, dhe kjo realizohet përmes një sistemi gjurmimi **(38, DVV, fq. 83)**. Zyra ka mbajtur të dhëna që prej vitit 2010 - 2011 rreth punësimit për çdo program studimit, si: pozicioni i punës, shoqëria, qyteti dhe vendi. Statistikat e punësimit publikohen në faqen zyrtare të Universitetit **(170)**. Universiteti ka nënshkruar marrëveshje me rreth 45 shoqëri private dhe publike, dhe bashkëpunon me shumë shoqëri të tjera që ofrojnë mundësi të shumta punësimi. Forumet e Hapura, Seancat Informuese, Vizitat në Shoqëri, dhe Panairi i Karrierës organizohen nga Zyra e Planifikimit të Karrierës dhe Studentëve të Diplomuar. Krahas kësaj, jepen edhe informacione rreth mundësive të punësimit për studentët dhe studentët e diplomuar nga të gjitha programet e studimit. Partnerët e jashtëm dhe alumnit, me të cilët u takua Grupi i Vlerësimit të Jashtëm **(M7)**, ishin shumë të kënaqur me kompetencat profesionale që zhvillojnë dhe gjuhën e huaj që mësojnë studentët. Stafi akademik, mësimdhënës, shkencor, dhe administrativ është i angazhuar që të

mbështetë studentët në gjetjen e punës, duke i ndihmuar me stazhe dhe duke iu mundësuar aftësitë e nevojshme për një karrierë të suksesshme (DVV, fq. 85). **[Kapitulli I, Standardi III.9].**

Gjetje

Praktika e mirë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi karakteristikat e mëposhtme të praktikës së mirë:

- ofrimi i gjerë të bursave për studentët e disavantazhuar **[Pika 5.4, Kapitulli I, Standardi III.4].**
- organizata e ekipeve të futbollit dhe volejbollit, si dhe 22 klube studentore aktive, që organizojnë aktivitete, si: forume, workshop-e, dhe programe trajnimi ku iu japin certifikata pjesëmarrësve dhe organizatorëve ose ndajnë çmime në konkurse kulturore dhe edukuese **[Pika 5.8, Kapitulli I, Standardi III.8].**

Pikat e dobëta

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë dobësi.

Rekomandimet

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk dha asnjë rekomandim.

Konfirmimi i veprimit të ndërmarrë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk bëri asnjë pohim.

Gjykimi

Standardet për Studentët dhe Mbështetjen e tyre janë **përbushur plotësisht.**

Lista e Evidencave

- M2 Mbledhje me Rektorin
- M3 Mbledhje me studentët e ciklit të parë
- M4 Mbledhje me studentët e ciklit të dytë
- M5 Mbledhje me studentët e ciklit të tretë
- M6 Mbledhje me stafin mësimdhënës
- M7 Mbledhje me partnerët e jashtëm dhe alumnit
- M9 Mbledhje me stafin mbështetës
- M10 Mbledhje me Dekanët e Fakulteteve dhe Përgjegjësit e Departamenteve
- M11 Mbledhje me Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë
- M12 Mbledhje me drejtuesit e lartë
- M13 Mbledhje me Grupin e Vetëvlerësimit
- Tur Tur në burime

- DVV Dokument Vetëvlerësimi
- I Korrespondencë dhe Plani për Veprimet e Vlerësimit Institucional të Universitetit
- Epoka
- 2 Direktivë “Për funksionimin e Bordit të Provimeve”
- 3 Udhëzues “Për provimet”
- 4 Formular për vlerësimin e provimeve
- 5 Formular për vlerësimin gjatë periudhës së provimeve
- 6 Raport javor rreth mësimdhënies në distancë në kontekstin e krizës së COVID-19
- 7 Informacione rreth anketave për COVID-19, që janë plotësuar nga studentët, stafi akademik dhe administrativ
- 8 Metodatat e ngritjes së platformave të mësimnxënies në distancë
- 9 Udhëzues për mësimdhënien dhe aktivitete të tjera gjatë semestrit të vjeshtës 2020 - 2021
- ON Plan Veprimi “Për masat organizative dhe administrative për rifillimin e mësimin dhe aktiviteteve të tjera arsimore në kampus”
- 11 Udhëzues “Për modalitetet në lidhje me realizimin e Provimeve Përfundimtare dhe Provimeve të Përsëritura të semestrit të vjeshtës 2020 - 2021 “
- 12 Raporti vjetor i aktiviteteve të Dekanit të Studentëve për vitin akademik 2019 - 2020
- 13 Statuti i Universitetit Epoka
- 14 Urdhër i Ministrit të Arsimit dhe Sporteve Nr. 146, datë 31.03.2017
- 15 Listë e akteve të brendshme ligjore në fuqi
- 16 Vendim i Senatit Akademik Nr. 2, datë 14.12.2016
- 17 Vendim i Bordit të Lartë të Universitetit Epoka Nr. 11, datë 11.01.2017
- 18 Listë e programeve të studimit që ofrohen nga Universiteti Epoka
- 19 Shembuj të vendimeve të mbledhjes së Senatit Akademik Nr. 2, datë 06.05.2020
- 20 Kodi i Etikës
- 21 Tabela e nevojave për burime njerëzore dhe infrastrukturë_2017 01 30
- 22 Vendim i Fakultetit të Ekonomisë dhe Shkencave Administrative Nr. 2, datë 06.07.2020 “Propozim rreth nevojave për burime njerëzore dhe infrastrukturë gjatë vitit akademik 2020 - 2021”
- 23 Shembull i vendimit të Rektoratit Nr. 1, datë 19.02.2021 “Për miratimin e listës së botimeve të anëtarëve të stafit akademik dhe ndihmës akademik për vitin akademik 2019 - 2020, sipas dispozitave të Direktivës së Universitetit Epoka “Për promovimin e botimeve shkencore”
- 24 Shembull i vendimit të Rektoratit Nr. 5, datë 04.02.2020

- 25 Shembuj të vendimeve të mbledhjes së Bordit Administrativ Nr. 6, datë 11.11.2020
- 26 Shembull i axhendës së mbledhjes së Rektoratit Nr. 20, datë 16.06.2020
- 27 Raport i vlerësimit përfundimtar të planit strategjik 2013 - 2017
- 28 Strategjia kuadër e Universitetit Epoka 2018 - 2022
- 29 Shembull i Planit Strategjik 2018 - 2022 për njësinë akademike - Departamenti i Ekonomiksit
- 30 Shembull i Planit Strategjik për Ndërkombëtarizimin 2018 - 2022 për njësinë akademike - Zyra e Marrëdhënieve Ndërkombëtare
- 31 Rregullore e Qendrës për Studime Evropiane
- 32 Rregullore e Qendrës së Kërkimit dhe Projektimit në Shkenca të Aplikuara
- 33 Ofertë akademike sipas ISCED-it
- 34 Propozim i Komisionit të Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë rreth pikave që duhen shtuar në Raportet e Departamenteve për Anketat e Vlerësimit të Pedagogëve të Kurseve, datë 2 korrik 2020
- 35 Vendim i mbledhjes së Rektoratit Nr. 5, datë 21.07.2020 “Për miratimin e pikave që duhen shtuar në Raportet e Departamenteve për Rezultatet e Anketave të Vlerësimit të Pedagogëve të Kurseve”
- 36 INSTAT Student në arsimin e lartë sipas fushave të studimit.
- 37 Shembull i raportit për studimin e tregut rreth hapjes së një programi Bachelor në Inxhinieri Softuerike
- 38 Raporti Vjetor 2019-2020
- 39 Politikë për pjesëmarrjen e stafit akademik dhe ndihmës akademik në aktivitete jashtë Universitetit dhe në aktivitete për të përfaqësuar Universitetin datë 19.11.2019
- 40 Rregullore “Për shkëmbimin studentor”
- 41 Direktivë “Për promovimin e botimeve të studentëve”
- 42 Skemë organizative e Universitetit Epoka EN&Sq
- 43 Rregullore e Universitetit Epoka “Për rekrutimin e stafit”
- 44 Shembull i përshkrimit të pozicioneve vakante të punës
- 45 Email-e që i dërgohen Jobs.ac.uk, AKADEUS dhe Duapune.
- 46 Direktivë “Për vlerësimin akademik dhe administrativ dhe përmirësimin e cilësisë”
- 47 Rregullore “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Përhershëm për dhënien e Diplomës Shkencore PhD”
- 48 Shembull i kontratës individuale të punësimit për “Stafin Akademik”, “Stafin Administrativ”, “Stafin Ndihmës-Akademik”, “Asistentët e Laboratorëve”, si dhe “Asistentët në Mësimdhënie”
- 49 Udhëzues për stafin
- 50 Broshura dhe fletëpalosje promovuese
- 51 Programi i planifikimit të karrierës për nxënësit e shkollave të mesme
- 52 Listë e aktiviteteve trajnuese për stafin
- 53 Listë e rasteve të bashkëpunimit institucional
- 54 Listë e anëtarëve të stafit që kanë marrë pjesë në programe shkëmbimi
- 55 Rregullore “Për kërkimin shkencor”
- 56 Shembull i vendimit për miratimin e kërkesës për mbështetje financiare
- 57 Direktivë “Për ngarkesën mësimore”
- 58 Formular i kërkesës për miratim për aktivitete studentore
- 59 Formular kërkesë për studentët
- 60 Listë e klubeve studentore
- 61 Listë e aktiviteteve të organizuara nga klubet studentore
- 62 Rregullore “Për disiplinën e drejtuesve, stafit akademik dhe administrativ”
- 63 Vendim për miratimin e nevojave për burime njerëzore dhe infrastrukturë 2020 - 2021

- 64 Vendim për miratimin e kalendarit të veprimtarive dhe aktiviteteve për vitin akademik 2020 - 2021
- 65 Ligji Nr. 9228/2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”
- 66 SKK - Standardet Kombëtare të Kontabilitetit dhe Raportimit
- 67 Udhëzues EIS për rolin e lektorëve
- 68 Udhëzues EIS për rolin e studentëve
- 69 Shërbimet e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit
- 70 Plani Strategjik i Zyrës së Koordinimit të TIK-ut 2018 - 2022
- 71 Listë e licensave të programeve softuerike
- 72 Certifikatë pronësie
- 73 Master Plani i Universitetit Epoka
- 74 Direktivë e Universitetit Epoka “Për blerjet”
- 75 Infrastrukturë në funksion të programeve të studimit
- 76 Depozitim i markës së EIS-së
- 77 Certifikatë e markës për regjistrimin e EIS-së
- 78 Direktivë “Për Bibliotekën”
- 79 Ligji Nr. 10138, datë 11.05.2009 “Për shëndetin publik”
- 80 Ligji Nr. 152/2015, datë 21.12.2015 “Për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin”
- 81 Zonë parkimi
- 82 Hapësira argëtimi
- 83 Raport i MASR-së për verifikimin e kapaciteteve 2020 - 2021
- 84 Format i anketës së kënaqshmërisë së studentëve
- 85 Fotografi të hapësirave të argëtimit
- 86 Tituj të librave të shtuar në katër vitet e fundit
- 87 Shërbimet e bibliotekës
- 88 Projekt strukturor i Universitetit Epoka
- 89 Projekt për sistemin e mbrojtjes nga zjarri dhe sigurinë në vendin e punës në Universitetin Epoka
- 90 Akt për mbrojtjen nga zjarri dhe sigurinë në Universitetin Epoka
- 91 Kontratë me TRAJF shpk
- 92 Trajnimi i stafit për mbrojtjen nga zjarri & evakuimi, fotografi
- 93 Politika e marketimit të programeve të studimit
- 94 Format i programit të planifikimit të karrierës për maurantët
- 95 Programi i Planifikimit të Karrierës për Maurantët për vitin akademik 2018 - 2019
- 96 Raport i Zyrës së Pranimeve për Numrin e Shkollave të Mesme dhe Nxënësve që marrin pjesë në Programin e Planifikimit të Karrierës për vitin akademik 2018 - 2019
- 97 Programi i Planifikimit të Karrierës për Maurantët për vitin akademik 2019 - 2020
- 98 Raport i Zyrës së Pranimeve për Numrin e Shkollave të Mesme dhe Nxënësve që marrin pjesë në Programin e Planifikimit të Karrierës për vitin akademik 2019 - 2020
- 99 Programi i Planifikimit të Karrierës për Maurantët për vitin akademik 2020 - 2021
- 100 Vendim i Senatit Akademik dhe Bordit Administrativ për themelimin e Fakultetit të Drejtësisë dhe Shkencave Sociale
- 101 Vendim i Senatit Akademik dhe Bordit Administrativ për miratimin e kuotave të pranimit në të gjitha programet e studimit për vitin akademik 2020 - 2021
- 102 Rregullore “Për studimet dhe provimet Bachelor”
- 103 Rregullore “Për programet e studimit të ciklit të dytë”
- 104 Rregullore “Për programet e studimit PhD”
- 105 Direktivë “Për transferimin e studentëve”
- 106 Politikë për Përmirësimin e Vazhdueshëm të Programeve të Studimit

- 107 Udhëzues për studentët 2020 - 2021
- 108 Raport vjetor i Departamentit të Ekonomiksit për vitin akademik 2019 - 2020
- 109 Certifikata të programeve të trajnimit
- 110 Formular për propozimin e ndryshimit të kurrikulës
- 111 Të dhëna për formularin e propozimit të ndryshimit të kurrikulës
- 112 Shembull i kryerjes dhe miratimit të ndryshimeve të kurrikulës së një programi studimi
- 113 Udhëzues “Për kryerjen e praktikës profesionale në programet e studimit të ciklit Bachelor dhe ciklit të Dytë të Integruar”
- 114 Udhëzues “Për kryerjen e praktikës profesionale në programet e studimit të ciklit Master Profesional”
- 115 Lista e stafit akademik gjatë periudhës 2017 - 2021
- 116 Format diplome
- 117 Suplement diplome në programin e studimit Bachelor në Inxhinieri Civile, Bachelor në Financë-Bankë, dhe Bachelor në Shkenca Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare
- 118 Tabela e Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve
- 119 Listë notash e studentëve
- 120 Manuali për Sigurimin e Cilësisë
- 121 Anketë e kënaqshmërisë së shoqërisë
- 122 Kapacitete akademike në Universitetin Epoka
- 123 Formular kërkese për pagesën e orëve shtesë të lektorëve
- 124 PAGESA SHITESË PËR NGARKESËN MËSIMORE NGA BUXHETI I UNIVERSITETIT EPOKA PËR PERIUDHËN 2017 - 2021
- 125 Program për Seancën e Orientimit për vitin akademik 2020 - 2021
- 126 Vendime të Senatit_Organizimi i Projektit të Diplomimit dhe Provimit të Përgjithshëm Përfundimtar (FCE)
- 127 Shembull të procesit të vendimmarrjes rreth njohjes së krediteve në kuadër të transferimit të programeve të ndryshme të studimit, që ofrohen nga tri Fakultete
- 128 Rezultatet e studentëve të diplomuar në tregun e punës: Dhjetë vite arritje
- 129 Listë e botimeve të stafit akademik gjatë periudhës 2016 - 2020
- 130 Dokumente për caktimin e kurseve të vitit akademik 2019 - 2020
- 131 Rregullore “Për programet e studimit të ciklit të dytë në Shkenca Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare”
- 132 Rregullore “Për programin e studimit Master Shkencor në Arkitekturë”
- 133 Rregullore “Për programin e studimit Master Shkencor në Inxhinieri Civile”
- 134 Informacione rreth kryerjes së praktikës profesionale në Departamentin e Inxhinierisë Kompjuterike
- 135 Listë e marrëveshjeve të bashkëpunimit midis Universitetit Epoka dhe palëve të treta
- 136 Listë e ekspertëve/profesionistëve që japin mësim në programet Master
- 137 Format i syllabusit të kursit
- 138 Vendime të Senatit Nr. 4, datë 10.02.2016, Nr. 5, datë 10.02.2016, dhe Nr. 1, datë 13.01.2016 “Për përcaktimin e nivelit minimal të kompetencave në gjuhën angleze si kriter pranimi për programet e studimit në ciklin Bachelor, ciklin e dytë të integruar, si dhe në ciklin e dytë”
- 139 Format i Shkresës së Performancës së “Epokës”
- 140 Format i kontratës së studimeve

- 141 Pjesëmarrje e studentëve në programe shkëmbimi
142 Direktivë “Për klubet studentore”
143 Kurrikulat e programeve të studimit në të trija ciklet e studimit në të trija Fakultetet
144 Direktivë “Për diplomimin në programet Bachelor”
145 Vendim i Rektoratit të Universitetit Epoka Nr. 1, datë 02.07.2019
146 Vendim i Rektoratit të Universitetit Epoka Nr. 4, datë 05.11.2019
147 Procesi i sekretimit të provimeve
148 Shtojcë e Rregullore “Për organizimin dhe funksionimin e KPSC-së”
149 Listë e rasteve të pjesëmarrjes së sponsorizuar në konferenca 2016 - 2020
150 Shembull i dokumenteve për aktivitetet trajnuese
151 Format i formularit të anketës së kënaqshmërisë së stafit akademik
152 Ligji Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”
153 Strategjia Kombëtare për Shkencën, Teknologjinë, dhe Inovacionin
154 Udhëzues për projekte kërkimore
155 Listë e rasteve të mobilitetit të studentëve dhe stafit 2017 - 2020
156 Listë e projekteve kërkimore
157 Raport i vlerësimit të brendshëm për programin e studimit “Doktoraturë në Ekonomiks”
158 Fusha prioritare të Kërkimit Shkencor, Teknologjisë dhe Inovacionit
159 Rregullore për botimet
160 Rregullore “Për etikën në veprimtarinë kërkimore dhe botuese”, MASR
161 Bursa për bashkinë e Vorës
162 Procedurat e Zyrës së Medias dhe Marrëdhënieve me Publikun
163 Politikë e Komunikimit me Jashtë
164 Rregullore për disiplinën e studentëve
165 Shembuj të njoftimeve të studentëve në forume të hapura
166 Politika për studentët me aftësi të kufizuara
167 Statuti i Këshillit Studentor
168 Shembull certifikate
169 Shtojcë e Formularit të Alumnive
170 Të dhëna të përditësuara për alumnit në vitin akademik 2018 - 2019
171 Niveli 6 i Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve
172 Shembull i programit orientues për stafin e ri me kohë të plotë dhe kohë të pjeshme,
datë
12.10.2020
173 Partneriteti Scopus Albania
174 Procedurat e punës së Zyrës së Pranimeve
175 Përshkrimet e punës së Ndhmës Pedagogëve
176 Deklaratë e konfidencialitetit të stafit
177 Vendim i Bordit të Lartë Nr. 7, datë 11.01.2017
178 Procedurat e Punës së Zyrës së Regjistrimit
179 Shembull i blerjes së librave nga biblioteka sipas kërkesave të departamenteve
180 Shembull i Kartës së Studentëve të “Epokës”
181 Procedurat e punës së Zyrës së Dekanit të Studentëve
182 Tabela përmbledhëse
183 Plani i Veprimit të Universitet Epoka për të përmbushur rekomandimet e ASCAL-it
184 Përgjigja e Universitetit Epoka ndaj krizës së COVID-19 Sigurimi i Vazhdueshëm i Cilësisë
185 Tabelë: Programet dhe Ciklet e Studimit që ofrohen nga Universiteti Epoka
186 Tabelë: Fushat/grupet kërkimore në nivel departamenti, 2021

- 187 Tabelë: Projekte të suksesshme gjatë periudhës 2017 - 2020
- 188 Tabelë: Numri i përgjithshëm i botimeve gjatë viteve akademike 2016 - 2017, 2019 - 2020
- 189 Tabelë: Listë e botimeve me ndikim të lartë gjatë viteve akademike 2016 - 2017, 2019 - 2020
- 190 Tabelë: Raporti lektor-student në nivel universiteti gjatë viteve akademike 2017 - 2018, 2019 - 2020